



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 02 nëntor 2018, në mbledhjen e XIII (trembëdhjetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës (34), kurse një anëtar nuk është zëvendësuar ende nga KQZ (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve (rreth 25).

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të rendit të ditës dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Avni Islami, nënvizoi, meqë kjo datë që është sot koincidon me një datë shumë të rëndësishme për Llapjanët, përkatësisht sot 29 vite kanë rënë heroikisht dy Dëshmorët, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, propozoj që para se të fillojmë me këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës t'i nderojmë me 1 minutë heshtje Dëshmorët në fjalë.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim dhe përkujtim të Dëshmorëve Afrim Zhitia dhe Afrim Fazliu, me rastin e 29 vjetorit të rënies.

Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, materialet i keni marrë me kohë, e di që ndoshta pak ka qenë volum i madh i materialeve dhe shpërndarja ka sjellë paksa probleme, por e rëndësishme është që të gjithëve ju janë dërguar me kohë thirrjet dhe materialet përkatëse për këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu njoftoj edhe rreth konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

znj.Mrika Thaqi, deklaroi, në rrugëtimet politike krijohen gjendje të atilla të cilat na shtynë të marrim vendime konform situatave dhe gjendjeve të krijuara qoftë për shkaqe dhe arsye objektive apo subjektive varësisht kush si donë t'i akceptoj, dhe në këtë aspekt unë deklaroj një vendim timin të marrë rreth të ardhmes time në aktivitetin politik, dhe atë, sot më 02.11.2018 tërhiqem nga Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe rrjedhimisht e të qenit pjesë e këtij subjekti politik, ndërsa nga tani aktivitetin tim politik dhe mandatin tim si këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës do ta ushtroj në kuadër të subjektit politik të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Kam arsye të mirë të besoj në veten time, jo gjithë herë kam marrë vendime të qëlluara por falë punës dhe angazhimit të palodhshëm kam gjetur mbështetje dhe përkrahje për të dal mbarë.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, e falënderojmë këshilltaren parafolëse dhe i urojmë shëndet dhe punë të mbarë në subjektin ku ishte edhe më parë.

**1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të mbajtura më;
05 shtator 2018 dhe 12 shtator 2018.**

z.Arbër Blaku, theksoi, kërkoj të bëhet një përmirësim në Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 05 shtator 2018, përkatësisht në diskutimin tim në faqen 8 ku thuhet, ‘..... konkretisht kamë ankesa të shumta ku njëra prej tyre është nga një lagje në fashitin prej nga vij unë të cilët ankohen se po shtroni asfalt tek shokët dhe bashkë partiakët e juaj....’, duhet të jetë; ‘.....konkretisht kam ankesa të shumta ku njëra prej tyre është nga një mik i imi për një lagje në fashitin ku jeton ai.....’.

Njëzëri u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të mbajtura më 05 dhe 12 shtator 2018, me konstatim të përmirësimit të një pjese të fjalisë të cekur nga këshilltari parafolës.

2. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

- Plani i veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve - 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, gjatë periudhës së parë të vitit 2018, Komunën e Podujevës e ka audituar një ekip e Auditorit gjeneral, auditim i cili për qëllim ka pas pasqyrat financiare për vitin 2017, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet e kryera nga Komuna. Bashkëpunimi ynë si Komunë me auditorët ka qenë shumë korrekt dhe krejt çka ju është dashtë iu është ofruar, për çka edhe jemi vlerësuar pozitivisht nga ana e auditorit të përgjithshëm. Fokusi i auditimit ka qenë tek pasqyrat financiare, menaxhimi financiarë dhe kontrolli si dhe tek rekomandimet e vitit paraprak dhe viteve të mëhershme. Opinionet e auditorit mund të jenë të ndryshme varësisht nga të gjeturat, por çdo herë të bazuara në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë, mohim i opinionit, opinion i kundërt, opinion i modifikuar, dhe opinion i pamodifikuar, ndërsa sqarimet për secilën nga këto opinione auditori i jap në faqet 31 dhe 32 të raportit. Ashtu siç keni vërejtur në materialet e dërguara se opinionit i auditorit për Komunën e Podujevës është, opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, sipas të cilit pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë për të gjitha spektret materiale, të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, për shërbime publike, për shërbime bazuar në kontabilitet me para të gatshme, si dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Rregulloreve financiare të Ministrisë së financave për pasqyrat vjetore financiare. Natyrisht një opinion i pamodifikuar jepet atëherë kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale, që janë, 1-pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit e që janë të zbatuara në mënyrë konsistente të qëndrueshme, 2-pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statutare dhe rregulloret relevante, 3-pamjet e paraqitura në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me antitetin e audituar, 4-pasqyrat paraqesin një shpalosje adekuate të të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare. Theksimi i çështjes sipas auditorit ka ndodh për dy defektet e shpalosura tek pasqyrat financiare, dhe atë, te pasuritë dhe te llogaritë e arkëtueshme. Konkluzion i përgjithshëm se ekziston ende hapësirë për të përmirësuar sa i përket qeverisjes brenda Komunës veç e veç në

lidhje me menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimeve menaxheriale dhe sistemin e auditimit të brendshëm, lista kontrolluese e vetëvlerësimit e cila plotësohet nga Komuna. Në lidhje me vërejtjet e ngritura nga auditori, janë dhënë edhe disa rekomandime në mënyrë që Kryetari i Komunës së bashku me stafin e vet t'i ndërmerr veprimet e duhura që çështjet e tilla në të ardhmen të mos përsëriten, dhe duke u bazuar në këto çështje ne kemi përgatitur një plan të veprimit lidhur me veprimet e kërkuara nga secili rekomandim në mënyrë që vërejtjet e njëjta mundësisht të mos përsëriten në raportet tjera të ardhshme, plan i cili i është përcjellë edhe auditorit të përgjithshëm. Për fund, këtë fjalë hyrëse po e përmbylli me konstatimin tim se nëse Komuna merr opinion të pamodifikuar, atëherë tatimpaguesit mund të jenë të kënaqur sepse taksat e tyre po përdoren në mënyrë korrekte dhe të drejtë.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, lidhur me raportin në fjalë dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm, i konsideron si një nga raportet vjetore që duhet t'i kushtohet shumë rëndësi. Krahas raporteve të tilla për vitet e mëparshme, Komuna e Podujevës ka arritur të realizoj donacione nga Ministrit dhe Organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se raporti si i tillë paraqet opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes, opinion me të cilin Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do të adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna. Iu mbetet Drejtorive përkatëse të cilat janë të atakuara me situata tani më të përshkruara në këtë raport të ndërmarrin hapat konkret për veprime të tilla që të mos përsëriten më. Rekomandojmë që Komuna e Podujevës të ndërtoj një database, me të dhëna konkrete për Komunën e Podujevës duke përfshirë edhe pasuritë dhe inventarin që posedon ku përmes softuerëve të qasshëm, jo vetëm për auditorin që paraqet çdo herë vërejtje për këtë çështje, por edhe për qytetarët tanë t'ju ofrohet një mundësi e mirë të pajisen me këto të dhëna. Gjithashtu edhe auditori i brendshëm të ofroj rekomandime paraprake për Drejtoritë përkatëse si paralajmërues për veprimet e caktuara që lidhen me fushveprimtarinë e Drejtorive përkatëse.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në këto raste është mirë që stafi profesional dhe që ka përgjegjësi dhe në menaxhimin e financave dhe shpenzimeve mendoj se do të ishte mirë të jetë pak më i zgjeruar dhe më autokritik lidhur me gjendjen që kanë. Lidhur me këtë raport unë kam një analizë më të zgjeruar, do të marrë pak më shumë kohë nëse më lejohet edhe nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nëse i bëjmë një analizë detaje këtij raporti të auditimit vërehet se Komuna e Podujevës gjatë vitit 2017 ka treguar një performancë të dobët të menaxhimit. Në raportin e auditimit që në të gjitha fushat janë konstatuar dobësi që kanë rezultuar me keq menaxhimin e buxhetit siç janë, dobësi në menaxhim financiar dhe kontroll, modeli i ulët i realizimit të buxhetit të investimeve kapitale, mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave, menaxhimi i dobët i kontratave të qirave, kompensimi jo i drejtë i punonjësve të administratës, mos respektimi i Ligjit dhe akteve tjera të shërbimit civil të Republikës së Kosovës, mos pagesa e faturave me kohë, kryerja e pagesave në mungesë të pranimit faktik të mallrave, hyrja në kontrata pa mjetet buxhetore, mos ndarja e përgjegjësisë në mes të komisioneve, ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale, vonesa në realizimin e projekteve kapitale, dobësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borgjeve, mos prezantimi i plotë i obligimeve, niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm dhe dobësi menaxheriale dhe në menaxhimin e rrezikut. Në faqen 5 të raportit janë dhënë konkluzionet dhe rekomandimet kryesore sipas raportit të auditimit dhe janë identifikuar dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare për të hyrat shpenzimet, pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme, dobësi këto të identifikuar në këto sisteme të rëndësishme janë rezultat i mos funksionimit të kontrollit të brendshëm për parandalimin e gabimeve apo edhe mashtrimeve. Mungesa e llogaridhënies dhe menaxhimit të rrezikut në nivel

jo të mjaftueshëm – duhur, do të thotë lë hapësirë për mosfunksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme, andaj mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme të Komunës në nivelin e mjaftueshëm – duhur lë hapësirë për gabime, për keq menaxhim por edhe keqpërdorim.

Në faqen 8 të raportit, opinioni i arkëtimit është opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, theksimi i çështjes ka rezultuar pa arsye tek pasuritë, tek llogaritë e arkëtueshme dhe për mungesën e ekzistencës, shembull të inventarit të paguar, që nuk ishin paraqitur saktë edhe te pasqyrat financiare të kësaj Komune. Pasuritë nuk janë menaxhuar në pajtueshmëri me Rregulloren 02/2013, andaj mos menaxhimi i duhur i pasurive dhe mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara me Rregullore kanë ndikuar që regjistrat e pasurisë së kësaj Komune të jenë jo të plota dhe jo të sakta për të gjithë pasurinë që do të duhej të prezantojnë regjistrat e pasurisë së Komunës po ashtu as pronat që janë në shfrytëzim dhe menaxhim të Komunës nuk janë prezantuar në regjistrat e kësaj Komune, çështje për të cilën jam në dijeni se ka qenë kërkesë edhe e këshilltarëve të Kuvendit në mandatin e kaluar që të sigurohen këto regjistra, por asnjëherë nuk u kompletuan. Llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar për 41,199.00€ si rezultat i gabimeve gjë që ka ndikuar në prezantim jo të drejtë dhe të jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare, andaj nga çështjet që ka ndikuar në opinionin e pamodifikuar me theksimin e çështjes vërehet se kontrollet e brendshme në Komunë nuk janë të dizajnuara mirë për parandalimin e gabimeve dhe të mashtrimeve të cilat kanë ndikuar që gjendja e pasurive të mos paraqitet saktë në vlerën e pasurive që i disponon kjo Komunë. Kryetari është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik dhe është përgjegjës për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime. Në faqen 8 të raportit, çështjet kyçe të auditimit, sipas raporti të auditimit, projekti i filluar në vitin 2009 për ndërtimin e ujësjellësit Vrella në vlerë prej 331,336.00€, vlera e pagesave për punë të kryera arrin në 173,000.00€ që rezulton rreth 52% të vlerës së kontraktuar e që është kryer për nëntë vite dhe që është bashkëfinansim me qytetarë të cilëve kjo Komunë ju ka marrë paratë por nuk ka realizuar asgjë. Në faqen 11 të raportit, kushti i veçantë i auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet, nga auditori vërehen se kontrollet se nuk kanë qenë efikase për të hyrat, dhe investimet kapitale për rritjen e të hyrave dhe parandalimin e rritjes së llogarive të arkëtueshme, këto ndikojnë që performanca e Komunës nuk është në nivelin e duhur për menaxhim efektiv dhe efikas. Shpenzimet për investime të trajtuara nga raporti, prej 61% në tremujorin e fundit të vitit ka vetëm në muajin dhjetor ishin shpenzuar 36%, kjo do të thotë se totali i shpenzimeve e ka rritë rrezikun, dhe kur jemi në dijeni se ishte vit elektorale e që kjo pastaj tregon edhe cilësinë e atyre projekteve për të cilat jemi dëshmitar të gjithë se kur ishte fushata zgjedhore bëheshin disa projekte sa për sy e faqe me qëllim që të fitohen vota, e jo t’iu kryhen shërbime cilësore qytetarëve. Vonesat për projektet kapitale dhe procesi i prokurimit është rezultat i planifikimit dhe menaxhimit të dobët të menaxhmentit, volumi i madh i punës në fund vit rritë rrezikun për gabime për pagesat e bëra dhe mund të rezultojë edhe në cilësi të dobët të produktit. Po ashtu në faqen 11 kemi të bëjmë me planifikimin dhe realizimin e buxhetit ku figuron edhe tabela, e që besoj se të gjithë keni parë dhe analizuar këtë raport, vërehet se buxheti total për investime kapitale është shpenzuar 78% dhe kjo ishte performancë e ulët dhe e dobët si rezultat i kërkesave të vonuara nga njësitë kërkuese brendapërbrenda administratës. Në faqen 14 të raportit, pagesat direkte dhe thesari janë pasoj e keq menaxhimit të fondeve të Komunës nga zyrtarët e Komunës, sipas këtij raporti punët e përfunduara nuk janë pagur dhe nga kjo vërehet se Komuna nuk kishte respektuar procedurat e rregullta për shpenzimin e parasë publike si rezultat i planifikimit të dobët të nevojave dhe realizimit të tyre, kjo është në kundërshtim me procedurat e

rregullta për shpenzimin e parasë publike. Dobësi tjetër që ka nxjerrë raporti në faqen 15 është mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave, vetëm 64% e që është një trend negativ i të hyrave krahasuar me vitin paraprak – 2016 e që auditorët kanë konstatuar se nuk ishte bërë planifikim i mirë dhe adekuat për mbledhjen e të hyrave. Pastaj në faqen 16 të raportit, thuhet se ngecjet nga të hyrat nga qiraja është shfrytëzimi i pronave komunale pa kontratë, dhe mos kryerja e obligimeve të qirasë sipas kontratës, kur nuk ndërpritet kontrata janë rezultat i keq menaxhimit të të hyrave dhe rritin rrezikun për keqpërdorime, po ashtu kjo ndikon në dëmtimin e buxhetit për shkak të keq menaxhimit të pronave të Komunës nga menaxhmenti i kësaj Komune. Në faqen 16 tek çështja e përditësimit të të dhënave që lidhen me verifikimin e 1/3 të pronave ka ndikim negativ në rritjen e të hyrave. Mandej një çështje të cilën e cekta edhe në fillim, është koeficienti i pagave dhe buxheti i koeficienteve për të cilën auditori ka konstatuar se edhe në kategorinë për paga janë vërejtur dobësi në funksionimin e kontrollit për menaxhim, si menaxhim i jo mirëfilltë të kompensimit të pagave, çështje për të cilën ne e kemi ngritur zërin edhe më parë dhe jeni dëshmitar të gjithë sa i përket diferencave të pagave ku për të njëjtin titull të punës dhe për të njëjtën punë paguhen ndryshe, posaçërisht ka qenë në pyetje inspektorati nëse ju kujtohet, mirëpo kjo do të thotë se tregon dobësi edhe në politikën e punësimit dhe realisht realizimit të të drejtave të tyre të punës në pajtim me ligjin, realisht këtu na është thënë se kemi dërguar në Ministrinë e Administratës Publike etj etj, por çështje të tilla duhet të planifikohen buxhet për rritje të koeficienteve, sipas raportit janë 10 raste të kësaj difference por tek çështja e mosplotësimit në auditim jo rastësisht është cekë çështja e mos rekrutimit të menaxherit – zyrtarit të prokurimit, çështje për të cilën jemi në dijeni se njeriu i pensionuar është angazhuar në prokurim për afër 1 vit dhe këtu ka shkelje sepse në nenin 12 paragrafi 3 të Ligjit për shërbimin civil është paraparë edhe marrëveshja për ofrimin e shërbimeve të veçanta, por edhe këto marrëveshje nuk mund të ofrohen pa procedurë ligjore, pa bazë konkurruese dhe procedurave të ndershme ku së paku duhet të jenë 3 persona në mënyrë që njëri prej tyre ta gëzojë të drejtën për marrëveshje për ofrim të shërbimeve të veçanta, dhe ani si është gjendja këtu jeni në dijeni të gjithë, andaj jo që është shkel ligji sepse ato marrëveshje janë me afat të caktuar, por ato janë përsëritë ngase në këtë Komunë ka të atillë që janë me vite me kontrata mbi vepër pa pas statusin e rregulluar sipas ligjit. Pastaj te çështja e ndarjes së subvencioneve, edhe këtu auditori ka vërejtur parregullsi ku kriteret të cilat i keni përcaktuar vet, se kur dikush mund të realizoj një subvencion në një vite nuk mund të realizoj të njëjtin në vitin tjetër, por ka raste të tilla me rastin e ndarjes së sistemit të ujitjes dhe sigurisht kjo ka ndodh për shkak të motivimit politik që keni, ngarkesës politike që keni për ti subvencionuar ata që jua japin votën. Sa i përket tenderëve sigurisht jeni në dijeni të gjithë se është ‘‘llugë’’ dhe nuk dëshiroj të hyjë fare në këtë çështje, mirëpo po ndalem tek papërgjegjësia, zyrtari kryesor financiar i kësaj Komune nuk tha asgjë po thujse ngase kur ai e dinë se nga viti 2011 ka rekomandime të cilat asnjëherë nuk i kanë zbatuar, mos të fjalim për ato të vitit 2016 apo të vitit 2017, do të thotë se i keni shmang procedurave ligjore për t’iu përgjigje rekomandimeve të caktuara nga organi i Zyrës së Auditorit të përgjithshëm, kështu që nga krejt kjo shihet se kjo Komunë vuan nga keq menaxhimi, nga jo profesionalizmi dhe që me këtë edhe dëmtohet buxheti por edhe qytetarët nuk arrijnë t’i realizojnë shërbimet që iu takojnë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e kemi analizuar raportin e auditimit të përgjithshëm për vitin 2017, jemi në dijeni se Zyra kombëtare e auditimit të përgjithshëm është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik-financiar i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve e gëzon pavarësinë funksionale financiare dhe operative. Natyrisht që ne të cilët kemi qenë këshilltarë të Kuvendit edhe në mandatin e kaluar, të gjitha këto të meta të cilat janë cekë në raportin e auditorit në fjalë, jemi të njohur me të njëjtat sepse shumica prej tyre janë

diskutuar disa herë në Kuvendin e Komunës. Bazë e auditorit për opinion është se sipas Rregullores 02/2013, të gjitha pasuritë jofinanciare, pas pranimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, dhe në këtë aspekt zyrtari i pasurisë nuk ka respektuar kërkesat e kësaj Rregulloreje sepse ka realizuar vetëm pasuritë për të cilat është realizuar pagesa, pastaj një numër i pronave që janë në shfrytëzim dhe në pronësi të Komunës në vlerë prej 20,000.00 € nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël, po ashtu edhe objekti “Mileniumi 2000” i cili është në pronësi të Komunës nuk figuron në regjistrin në fjalë. Çështje kyçe e auditimit është edhe projekti për ndërtimin e ujësjellësit Vrella, i cili ka qenë në bashkëfinancim me qytetarët dhe ka filluar në vitin 2009, në vlerë prej 331, 336.00 €, por që i njëjti ende nuk ka përfunduar, projekte për të cilin qytetarët qysh në atë kohë kanë participuar me rreth 70,120.00 € shumë e cila bartet vit pas viti për shkak të mos realizimit të këtij projekti e që sipas Komunës një prej fshatrave ka krijuar pengesë për shfrytëzimin e burimit të ujit përdorur pagesa për punët e kryera në disa fshatra janë kryer në vlerë 173,000.00€. Pastaj kemi të bëjmë me nivelin ulët të investimeve kapitale ku Komuna ka pasur probleme me ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale, në njërin anë kishte kërkuar buxhet shtesë me arsyetimin për t’i mbuluar shpenzimet për disa projekte ndërsa vetëm 78% e kësaj kategorie është shpenzuar, e që sipas Komunës arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të këtij buxheti janë planifikim jo i mirë i shpenzimeve, vonesat në inicim të lidhjeve të kontratave si dhe ngecje në realizimin e projekteve. Pagesat direkte nga thesari prej 55,393.00€ për mallra dhe shërbime dhe 15,888.00€ për investime kapitale ishin ekzekutuar përmes nenit 39.2 dhe direkt nga thesari, pra punimet janë përfunduar por që nuk janë bërë pagesat sipas procedurave dhe rregullave për shfrytëzimin e parasë publike dhe si rezultat i planifikimit jo të mirë. Kjo formë e pagesave përmes vendimeve gjyqësore rrezikon realizimin e projekteve kapitale, pagesa të cilat po ashtu dëmtojnë buxhetin për shkak të shpenzimeve përmbartimore. Pastaj mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave, Komuna e Podujevës ka shënuar trend negativ në realizimin e të hyrave ku vetëm 64% të planit e ka realizuar apo 19% më pak se në vitin paraprak dhe në këtë aspekt Kryetari i Komunës duhet ta analizoj arsyet e mos realizimit të të hyrave dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Pastaj kemi ngecjet për të hyrat nga qiraja, lidhur me këtë kemi një rast ku Komuna ka ngarkuar me qira mujore një person edhe pse i’u kishte ndërprerë qiraja, por i njëjti person vazhdoj ta shfrytëzoj pronën e Komunës pa kontratë, obligimet e të njëjtit ndaj Komunës arrijnë vlerën prej 12,538.00€, ndërsa një rast tjetër qiramarrësi është i obliguar të paguaj shumë prej 330.00 € qira mujore, kurse ai person nuk ka paguar asnjëherë, kurse borxhi është rritur dhe ka rritë në 22,110.00€, mirëpo të njëjtit nuk i është ndërprerë kontrata dhe ende vazhdon ta shfrytëzoj të njëjtën pronë. Tek kompensimi i pagave dhe buxhetimi i koeficienteve, bëhet fjalë se si Komuna ka dëmtuar punonjësit me paga, edhe pse ka pasë buxhet të mjaftueshëm 14 inspektor janë të buxhetuar me koeficient 7, ndërsa 13 prej tyre janë paguar me koeficient 6, pastaj tek shërbimi kadastral 5 pozita janë të lejuar me koeficient 7 ndërsa vetëm 1 prej tyre paguhet me këtë koeficient. Në raport kemi edhe çështjen e marrëveshjeve për shërbime të veçanta ku thuhet se Komuna kishte angazhuar 23 persona dhe në 10 rastet e rishikuara auditori ka vërejtur se zyrtarët ishin angazhuar për periudhë më të gjatë se 6 muaj, ndërsa 2 prej tyre ishin duke punuar që nga viti 2010, staf i cili ishte angazhuar në pozita të ndryshme, si për shembull, konsulent, zyrtar për bujqësi, digjitalizim të rrugëve, roje, pastrues etj. Tek ndarja e subvencioneve dhe transfereve, përkrahja e fermerëve me sistemin e ujitjes pikë pikë, Komuna kishte vendosur kritere që fermerët të cilët ishin përfitues të mëhershëm të subvencioneve të mos jenë përfitues edhe për herë të dytë, mirëpo këtu auditori ka gjetur shumë raste ku persona të njëjtë kanë qenë përfitues të subvencioneve nga dy e më shumë herë nga Komuna e Podujevës, andaj mos respektimi i këtij kriteri nga vetë Komuna lë të kuptohet se është një keqpërdorim i

qëllimshëm dhe njëkohësisht dëmton përfituesit e rinjë. Realizimi i pagesave pa pranim të mallit, rast ku është cekur se për inventarizimin e objektit të ri të Komunës ishin paguar 74,992.00 €, e që Komuna kishte kryer pagesa në vlerë prej 61,000.00€ në dhjetor të vitit 2017, menaxheri i kontratës kishte nënshkruar për pranim të inventarit edhe pse inventari nuk gjendej në objektin e ri të Komunës, kryerja e pagesave në mungesë të pranimit faktik të mallit bie ndesh me rregulloret financiare për shpenzimin e parasë publike dhe përbën rrezik të vazhdueshëm që Komuna të humb parat e dhëna, kjo bën të dyshosh se Komuna është përfshirë në marrëveshje verbale dhe joligjore me operatorët ekonomik. Mandej kemi të bëjmë me ndarjen e tenderëve ku tek kontratat auditori kishte dhënë vërejtje se nga 2009 kontrata të nënshkruara përmes procedurave tenderuese 68 prej tyre ishin bërë sipas procedurave minimale, ndërsa 41 prej tyre ishin me kuotim të çmimeve. Mosplotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit, sipas Rregullores 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, neni 4 për pozitën drejtuese thuhet, në rast se nuk ka kandidat nga nëpunësit civil ekzistues atëherë duhet të zhvillohen procedura të hapura të rekrutimit, por edhe përkundër kësaj pozite e udhëheqësit të prokurimit kishte mbete e lirë që nga janari i vitit 2017, përkatësisht nga dita kur ishte dal në pension udhëheqësi përkatës, Kryetari kishte angazhuar si ekspert në fushën e prokurimit ish menaxherin e prokurimit me marrëveshje për shërbim të veçantë fillimisht për 6 muaj e pastaj edhe për 6 muaj të tjerë, gjë që bie ndesh me ligjet në fuqi. Kontratat e lidhura pa mjete të buxhetuara, edhe këtu Komuna kishte nënshkruar disa kontrata ku kishte hyrë në obligime më të larta se sa që ishin të lejuara me buxhetin e vitit 2017, bëhet fjalë për projektin “asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Revuç” ku kontrata ishte nënshkruar në vlerë prej 91,463.00 €, ndërsa ishin të buxhetuara vetëm 35,000.00 €, kurse për projektin” asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim” kontrata ishte nënshkruar në vlerë prej 131,000.00 € përderisa të buxhetuara dhe zotuar ishin vetëm 90,000.00 €. Vonesat në realizimin e projekteve, me kontratat e asfaltimit të disa rrugëve, lagja Bajgora dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Obrançë, të nënshkruara në vitin 2016 është paraparë që ky projekt të kryhet brenda 50 ditëve, por këto projekte janë përfunduar në vitin 2017 konkretisht me 7 muaj vonesë. Pra këto janë disa nga të gjeturat e auditimit të përgjithshëm, andaj ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që t’i mbikëqyr këto të gjetura dhe në të ardhmen të përmirësohen.

z.Bashkim Sylja, theksoi, gjatë auditimit për vitin 2017 auditori i përgjithshëm ka evidentuar shumë shkelje dhe sikurse në vitet e kaluara ka dhënë shumë rekomandime. Parafolësit i përmendën disa, por edhe unë po i cekë disa prej tyre, mos regjistrimi i të gjitha pasurive jo financiare, mos regjistrimi i të gjitha pronave komunale, pastaj inventari i objektit të ri të Komunës i pranuar me vlerë 52,384.00€ që realisht nuk është pranuar, mandej për vitin 2017 llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin mbivlerësuar me 41,199.00€, në raportin për obligimet e papaguara nuk janë përfshirë të gjitha obligimet që i takonin Komunës, regjistri i pasurive kapitale dhe llogaritë e arkëtueshme nuk janë prezantuar drejtë, po ashtu auditori nuk e ka gjet mirë Komunën as në kontrollin as në menaxhimin në realizimin e të hyrave dhe tek investimet kapitale si dhe as në proceset e prokurimit. Komuna ka shënuar trend negativ në realizimin e të hyrave ku vetëm 64% e planit është realizuar apo 19% më pak se në vitin e kaluar, menaxhimi i dobët i kontratave të qirave, dhënia me qira e pronave komunale pa kontratë, pastaj Komuna nuk ka arritur të kryej verifikimin e 1/3 të pronave të paluajtshme ashtu siç kërkohet edhe me ligj, mos harmonizimi i koeficienteve për paga dhe mëditje për punonjësit edhe pse ka pas buxhet të mjaftueshëm, mosplotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit për të cilin thuhet se rrezikon që performanca dhe niveli i përgjegjësisë në fushën e prokurimit të je shumë i ulët, mangësi në procesin e pagesave ku sipas raportit në tri raste pagesat e faturave nuk janë kryer brenda 30 ditëve edhe pse kjo çështje është e paraparë me ligj këto pagesa kishin zgjatur më shumë se gjashtë muaj.

Te ndarja e subvencioneve auditori ka gjetur shkelje për mosrespektim të kriterëve, e që kemi shumë bujq të cilët nuk janë subvencionuar asnjëherë nga Komuna kurse kemi raste që persona të njëjtë janë subvencionuar dy herë brenda një viti. Realizimi i pagesave pa pranim të mallrave, çështje kjo e cila bie ndesh me rregullat financiare për shpenzimin e parasë publike, pastaj vonesa në realizim të projekteve, auditori ka bërë vërejtje edhe në adresim të rekomandimeve të viteve të kaluara ku shumica prej tyre nuk janë adresuar, ku për vitin 2017 auditori i përgjithshëm Kryetarit të Komunës i ka dhënë 22 rekomandime si dhe qeverisjen në vitin 2017 e ka cilësuar si qeverisje pa planifikim, pa realizim dhe pa mbikëqyrje.

z.Adnan Zymeri, theksoi, raporti i auditimit të pasqyrave financiare është një dokument që përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2017, raport në të cilin theksohen çështjet, deklarohen të gjeturat, identifikohen rreziqet dhe jepen rekomandimet. Duke u bazuar në këtë raport, auditori i përgjithshëm ka identifikuar 22 çështje që lidhen me aktivitetet e qeverisjes lokale për vitin 2017 dhe ka dhënë rekomandime përkatëse për ato çështje. Nga opinioni i përgjithshëm i auditorit theksohet se pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe ligjet në fuqi, mirëpo ka edhe çështje për të cilat Komuna duhet ta rritë fokusin dhe angazhimin për t'i përmbushur rekomandimet e theksuara çështjet si, kompensimi i pagave dhe rregullimi i koeficientve, ndarja e subvencioneve dhe transfereve, mosplotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit dhe rritja e intensitetit për inkasim më të lartë të të hyrave, paraqesin disa nga çështjet për të cilat Komuna duhet të shtoj angazhimin dhe të rritë vlerësimin e saj në përgjithësi. Për plotësimin e pozitës së udhëheqësit të prokurimit dhe për çështjen e ndarjes së subvencioneve, Komuna ka ndërmarr hapa konkret duke emëruar shefin e prokurimit dhe duke marrë vendim për themelimin e komisionit për verifikimin e përfituesve të subvencioneve, kështu që ka përmbushur dhe respektuar rekomandimet e auditorit, ashtu siç është në përpjekje të vazhdueshme edhe për përmbushjen e rekomandimeve që lidhen me çështjet e tjera të paraqitura në raport. Pas një vlerësimi racional, pajtohemi me të gjeturat e auditorit mirëpo konsideroj se vetëm me angazhim të përbashkët dhe opinione konstruktive do t'i kontribuojmë Komunës tonë në vlerësimet e ardhshme nga institucionet e tilla.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, raporti i auditorit është sjellë dhe është shqyrtuar nga të gjithë, këtu nuk mund të jenë dy të vërteta po ka një të vërtetë dhe një të pavërtetë. Pa marrë parasysh se si e paraqet raportin auditori, të modifikuar apo të pamodifikuar, neve si këshilltarë të Kuvendit të Komunës, pa dallime politike, është dashtë t'iu interesoj problematika e Podujevës, e jo të merremi se çka thotë auditori me opinionet e tij rreth këtij dokumenti, për të shkuar në drejtim të rrugës penale, gjë e cila aspak nuk më bënë përshtypje, por përshtypje më bënë se ne këtu e dimë, por që nuk është përgjegjësi e jona por e Ekzekutivit duke filluar nga Nënkryetari i Komunës i cili është prezent këtu sepse Kryetari edhe njëherë e kam cekë se nuk vie fare në Kuvend për të dëgjuar se çka po bëhet me Podujevës gjë për të cilën fundja e ka përgjegjësi e vetë. A mundet ndokush nga ky Kuvend i Komunës ta arsyetoj që një pronë komunale e cila qe 4 vite një Drejtori e caktuar ja jep një personi dhe ai nuk paguan asnjë cent Komunës, a mund ta arsyetoj LDK-ja këtë me që po e mbështet raportin e auditimit, nëse po urdhëroni mund ta merr fjalës ndonjëri dhe ata arsyeton atë qiramarrës politik i cili para 4 viteve ka marrë pronën me qira dhe nuk paguan qiranë, dhe për këtë mund të flasim edhe në një anë tjetër, nëse ai person nuk e paguan qiranë, atë e paguan te ndokush tjetër privatisht ose drekon bashkë me ndokënd. Pastaj a dinë ndokush nga ky Kuvend i Komunës dhe nga ky Ekzekutiv i Komunës të më tregoj çfarë bën Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit qe 1 vit në këtë mandat dhe çfarë ka bërë 4 vite në mandatin e kaluar me pronën

publike sa ishte Drejtor i një Drejtorie tjetër, përse i nderuar Drejtor z.Durim Salihu duke përfshirë ju z.Abaz Llugaliu Drejtor i Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, a jeni në dijeni kush është ai qiramarrës, përse i nderuar z.Llugaliu po e degradoni punën deri në këtë nivel që të ngritët debat për gjëra të tilla. Mua personalisht si këshilltar i këtij Kuvendi aspak nuk më interesin çfarë thotë në raportin e auditorit të përgjithshëm. Me çfarë përgjegjësie lejoni ju që të shfrytëzohet prona publike duke falë kurse në anën tjetër ankoheni që nuk keni buxhet, si i arsyetoni ankesat e qytetarëve, përgjegjësia është e juaja, madje në konkurrencë i keni eliminuar ndoshta shumë biznesmen të cilët ndoshta që do ta paguante qiranë, kurse e keni shpall fitues njeriun i cili nuk paguan qira, madje madje ja keni vazhduar, përndryshe ndoshta do të ishte në rregull ta shfrytëzonte atë pronë deri në 1 vit pa pagesë dhe do ta përkrahja që t'i jepet shans secilit biznes të tillë i cili ka bërë investime sepse nuk do të ishte mirë qysh në fillim të kushtëzohet me pagesa, mirëpo për 4 vite nëse një person nuk dëgjon fare për institucionin ai person është njeri i juaji ndokujt. Çka është duke bërë kjo qeverisje lokale e Podujevës, mendoj se duhet të marrë guximin ndokush nga LDK-ja të kërkoj përgjegjës prej njerëzve të vet, këtë nuk e them në mënyrë politike. Këshilltari parafolës e lavdëroj raportin në fjalë, por pas kësaj pike do të diskutojmë edhe për raportin financiar 9 muaj sipas të cilit për kompaninë e këtij këshilltari "Toifor" 180,000.00 € janë pagur, dhe unë do t'i cekë të gjitha rrugët që ajo kompani ka marrë punë dhe është paguar dhe nuk ka bërë asgjë po thuajse, shembull, nga këtu mund të shkojmë të vizitojmë lagjen "Xhemajli" për të cilën po të ishte stazë e biçikletave marre është për një Drejtor i cili e mbikëqyrë atë punë infrastrukturore të lejoj të ndodh ajo gjendje. Shumë pak ka rëndësi ta zëmë a je në pushtet apo në opozitë, nëse familjet tona nuk mund ta shkollojnë nxënësin e tyre në shkolla të Podujevës, pastaj nuk mund ta shëroj fëmijën e tyre në Podujevë, gjë për të cilën kemi pas disa skandale mediale ku ka vdekur fëmija rrugës për neglizhencë politike të një qeverisje e cila shikon vetëm të mbaj pushtetin, pastaj nuk keni qenë në gjendje që 18 vite të siguronin një banesë sociale për një person që i është djegë shtëpia nga rrufeja, të paktën vetëm deri në stinën e pranverës. Çka ka peshë këtu a jemi këshilltarë të këtij Kuvendi, pa marrë parasysh cilit subjekt politik i takojmë, të ngritim duart për interesa të tjetër kujt që mundohet të na manipuloj. Nëse ndokush nga LDK-ja mund ta arsyetoj këtë raport, ta kërkoj fjalën dhe ta arsyetoj asnjë inkasim prej pronës publike ta zëmë, pastaj të tregoj përse nuk bëhet inkasimi nga qiramarrësit e caktuar, kurse dikush tjetër inkasohet 100%. Pastaj të kërkoj fjalën z.Durim Salihu dhe të tregoj se çfarë ka bërë që rreth 8 muaj që është Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, përse i nderuar nuk shkon të vësh shiritat te ato prona, a mund të na jepni arsyetim. Andaj mos të bëhet shkak sepse mendoj se aq në nivel të ulët ka ardh ky Kuvend, ndoshta është mirë të mos diskutojmë fare dhe mos të vijmë fare këtu derisa të vije puna në nivel. E kam parasysh se për shkaqe politike e keni të vështirë të reflektoni, por ju tregoj se shumë i pandërgjegjshëm është çdo këshilltarë këtu i cila ka ardh me vota të qytetarëve dhe i cili ngritë dorën për, i cilit do subjekt politik qoftë ai/ajo nëse një pushtet punon kështu në këtë formë. Mbani Drejtorë të papërgjegjshëm, që ku i keni këtu, por mos u ankoni për buxhet i nderuar Kryesues i Kuvendit. Përgjegjësini për pronën publike e ka z.Abaz Llugaliu, ndërsa përgjegjësini për vënien e shiritave dhe mbikëqyrjen e asaj prone, në këtë rast, e ka z.Durim Salihu, pra e ceka edhe më parë se këta dy Drejtorë janë përgjegjës për sigurimin e të hyrave financiare nga qiraja, dhe nëse këta dy Drejtor marrin fjalën dhe deklarohen se nuk mund t'ia marrin pronën ose qiranë atij personi, atëherë ta vazhdojnë edhe për 4 vite tjera me të njëjtën gjendje. Pastaj kemi edhe rastin e mandatit të kaluar ku kandidatit për Kuvend të Komunës Sylë Deshishku ja keni dhënë për shfrytëzim bilbordet në qytet dhe i njëjti ka mbet borxh rreth 24,000.00€.

z.Durim Saihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, meqë nga parafolësi u zura në fjalë, mora fjalën t’i përgjigjem në mënyrë shumë të shkurtër dhe konkrete. Nga data 20 mars 2018 prej që jam emëruar drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit e deri më sot, çdo punë që është bërë në kuadër të planifikimeve të Drejtorisë që unë e menaxhoj, ka qenë është dhe do të jetë transparente, qoftë nga unë si drejtor qoftë nga stafi i Drejtorisë, edhe në të ardhmen për aq kohë sa jam drejtor i kësaj Drejtorie, pra çdo punë që bëhet në kuadër të Drejtorisë është e njohur për publikun. Unë jam në dijeni shumë mirë për kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore që kam dhe veproj në harmoni me ato kompetenca dhe përgjegjësi, kurse në momentin që të njëjtat i shkeli, qoftë me apo pa vetëdije, atëherë të merret Gjykata me mua sepse këtu jam dhe nuk kam ndërmend të shkoj askund, mirëpo nuk është mirë që askush të bën etiketime, shpifje, trillime, andaj i nderuar z.Rafet Llapashtica, ju lus të mos fyeni sepse unë asnjëherë nuk e ka bërë një gjë të tillë ndaj juve dhe ndaj askujt tjetër. Sa i përket asaj që parafolësi e ceku rreth vendosjes së shiritave, ligji shumë mirë e përcakton se kompetencë e kujt ajo punë.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, nuk e pash të arsyeshme të marrë fjalën për arsye se pothuajse të gjithë ata që diskutuan për raportin e auditorit të përgjithshëm janë dakord që e lexuan vetëm atë që e ka thënë auditori, dhe është ashtu, mirëpo më bëri ta marrë fjalën fakti që pjesë e këtij raporti është edhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve – 2018, dhe pikërisht e gjetura në numrin 4, mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave, në planin e veprimit kemi edhe emra konkret të firmave të cilat janë qoftë në procedura gjyqësore qoftë edhe në procedura përmbarimore, dhe njëra prej atyre që i cilësua është edhe në raportin të cilin e posedoni dhe e keni përpara të gjithë, fjala është për “FMB Kualitetit” Gjilan, e cila është në procedurë gjyqësore dhe atë përmbarimore dhe vetëm pritet kur ai person të ketë llogari, përkatësisht besoj se të gjithë jeni në dijeni për procedurat e përmbaruesit, pra kur kjo kompani të ka mjete në llogarinë e saj, mjetet përkatëse do të transferohen në llogarinë e Komunës, dhe besoj se pa asnjë dyshim ato mjete do të transferohen në llogarinë e Komunës sikurse që do të transferohen edhe nga të gjithë të tjerët që janë të listuar por edhe të tjerë që nuk janë të listuar.

Te e gjetura me numër 5, ngecjet e të hyrave nga qiraja, edhe në këtë aspekt kemi një numër të atyre të cilët i shfrytëzojnë pronat publike dhe kanë borxhe, andaj ju kemi treguar edhe juve këshilltarëve të Kuvendit që të njëjtat janë në procedura gjyqësore dhe përmbarimore në mënyrë që ato të hyra të vjelën, dhe do të vjelën. Sigurisht që nuk jemi të kënaqur asnjëri prej nesh për vonesa të tilla dhe mos pagesa të tilla por megjithatë janë të listuara në listën që të gjithë ju e posedoni dhe e keni para vetës, listë e cila besoj se sot mund të jetë edhe më e gjatë e atyre shfrytëzuesve të objekteve komunale të cilët kanë borxhe ndaj Komunës. Pra kjo ishte që më bëri të marrë fjalën sepse edhe këto janë të shkruara dhe asgjë nuk po shpiku as nuk po e them që ju nuk e keni në materialin e kësaj pike.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike, sigurisht jeni në dijeni se nuk parashihet procedurë e votimit për raporte të tilla por konsiderohen vetëm sa për njoftim dhe diskutim eventuale, sepse janë të gjetura, vlerësime, sugjerime, punë të kryera, konstatime dhe të gjitha çështjet tjera të nevojshme për fushën përkatëse, të cilat nuk mund t’i ndryshojmë, andaj mund të kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti Financiar për periudhën janar – shtator 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, duke kryer një obligim ligjor paraqes raportin financiar për periudhën janar-shtator 2018 qëllim i së cilit është prezantimi i pasqyrave financiare të zhvilluara përgjatë kësaj periudhe. Me theks të veçantë do të paraqes një informatë të shkurtër lidhur me shpenzimet në nivel të Komunës të ndodhura sipas kategorive ekonomike dhe sipas burimeve prej nga janë financuar, duke bërë një krahasim të të gjitha llojeve të shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë kanë arritur shumën 11,908,637.00€, dhe atë paga dhe mëditje 8,807,072.00€, mallra dhe shërbime 808,787.00€, shpenzime komunale 215,981.00€, subvencione 217,066.00€ dhe për investime kapitale 1,859,732.00€, shprehur në përqindje është 55.7% e buxhetit të planifikuar vjetor, dhe nëse bëjmë një krahasim të shpenzimeve me periudhën e vitit paraprak do të vërehet një rritje e krahasueshme prej 1.52% në total.

Sa i përket planifikimeve dhe realizimeve të të hyrave vetanake përgjatë kësaj periudhe të cilat janë të paraqitura në tabelën e të hyrave në kuadër të raportit ku inkasimi për këtë periudhë është 902,407.00€ ose 58% e planit vjetor e që krahasuar me periudhën e njëjtë të viti paraprak është 9.23% më e ulët. Në këtë periudhë nuk janë llogaritur të hyrat nga donacionet e jashtme që janë 136,651.00€ grand i performancës dhuruar nga Qeveria Zvicerane. Edhe pse të hyrat janë në nivel jo të kënaqshëm megjithatë na gëzon fakti që tatimi në pronë është realizuar 77%, mirëpo edhe përkundër kësaj mendoj se mbetet edhe shumë punë për të bërë në periudhën vijuese të vitit në mënyrë që ky vit të përmbyllet suksesshëm edhe sa i përket shpenzimeve, në veçanti do të përqendrohemi që investimet kapitale të realizohen ashtu siç janë planifikuar dhe po ashtu inkasimi i të hyrave të jetë sa më i lartë i mundshëm. Për fund mund të konstatojmë se është një raport i cili jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave për periudhën raportuese.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, raporti financiar për periudhën janar-shtator 2018, përtej faktit që paraqet një pasqyrim të aktiviteteve financiare apo realizimit të buxhetit të Komunës për periudhën referuese, më shumë se kaq duhet të shihet si një momentum i transparencës dhe llogaridhënies së Ekzekutivit të Komunës karshi Kuvendit të Komunës në drejtim të shpenzimit të parasë publike për realizim të projekteve dhe shpenzimeve tjera komunale. Prezantimi i të hyrave dhe të dalave jo vetëm në sektorë por edhe në kode konkrete na jep një pamje edhe më të qartë të gjendjes faktike se si qëndron Komuna sa i përket shpenzimit të buxhetit. Dëshiroj të theksoj edhe një çështje që ka të bëjë me pagesat për projektet kapitale ku na jepe një qasje shumë konkrete duke u cekur edhe emrat e operatorëve ekonomik, projekteve konkrete dhe njëkohësisht edhe shumave buxhetore të realizimit të atyre projekteve, e them këtë sepse në shumicën e Komunave të Kosovës kjo pjesë nuk përfshihet në raportet e tilla financiare, dhe për faktin se ne çdo herë jemi të prirë të vlerësojmë dhe të gjykojmë mbi bazën e krahasimeve, dhe kur jemi te kjo pjesë, krahasimi nga viti në vit e përmbush rregullativën ligjore por edhe e lehtëson analizën e këtij raporti. Në disa kategori vërehet rritje e shpenzimeve, por s’do mend që nëse duam të bëjmë investime në sektorë të caktuar, shembull, në arsim apo diku tjetër, natyrisht se ato investime kanë edhe kosto financiare. Ku flasim në përgjithësi për ecurinë e realizimit të projekteve ne bashkërisht si Kuvend i Komunës, pa dallime, duhet të përçojmë mesazhin e realizimit të këtyre projekteve në kohën dhe dinamikën e paracaktuar varësisht nga projektet konkrete por njëkohësisht edhe tek Drejtoritë e të cilat janë të ngarkuara për realizimin e atyre projekteve. Për fund ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim praktikën e sjelljes së paraqitjes së raporteve konkrete në vazhdimësi pranë institucionit të Kuvendit të Komunës si organ më i lartë legjislativ në Llap.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sa herë që marrin fjalën këshilltarët e Kuvendit të LDK-së na bëjnë përshtypje që nuk e kemi të njëjtin raport para vetës. Raportin financiar të cilin e kemi analizuar ne, edhe pse është shumë e pamundur, sepse në këtë po kontribuon Ekzekutivi i Komunës duke sjellë një raport të pa detajuar, edhe pse janë zotuar për transparencë dhe të jetë i kuptuar për qytetarët rreth shpenzimeve të parasë publike. Nga tri raportet e tilla që kemi pasë deri tani, pothuajse në shumicën e rasteve nuk mund të llogaritet si raport dhe për këtë nuk e di a nuk po doni apo nuk po dini, nëse nuk doni kemi të bëjmë me keqpërdorim të parasë publike, ndërsa nuk po dua të besoj se janë të dyja. Sa i përket asaj që parafolësja z.Fatlume Jaha e ceku, unë kam kontrolluar edhe komunat tjera sa i përket raporteve financiare dhe në një komunë e cila qeveriset prej LDK-së në bashkëqeverisje me LVV-në, Komuna e Vushtrrisë, raportin financiar e ka shumë të detajuar dhe do të ishte shumë më mirë të merret shembull edhe prej tyre. Vërejtjet më të mëdha që kemi në këtë raport janë shpenzimet kapitale të ulëta të buxhetit të planifikuar ku nga 6,489,514.00€ janë investuar vetëm 1,859,732.00€ e që në përqindje i bie 28% e buxhetit për nëntëmujorin e vitit, kurse deri në fund të vitit kemi edhe 3 muaj dhe kemi edhe 72% të buxhetit, andaj si mundet të shpenzohet mirë ky buxhet i mbetur për aq pak kohë sa ka mbetur kur jemi në dijeni se tani edhe moti do të ndryshoj dhe do të pamundësoj realizimin e investimeve kapitale. Ky trend i investimeve kapitale nënkupton sfidat buxhetore dhe nëse vazhdon ky trend do të teprojnë minimum 60% e buxhetit, andaj ky suficid aq i lartë tregon paaftësinë dhe papërgjegjshmërinë e këtij pushteti kur dihen nevojat e mëdha të Komunës tonë për projekte kapitale dhe e dimë se si ndikon mos realizimi i këtyre projekteve në zhvillimin e gjithmbarshëm socio-ekonomik, gjë për të cilën ne ju kemi lajmëruar qysh në tremujorin e parë të vitit që nëse vazhdohet me këtë trend të investimeve, do të vijmë në këtë gjendje. Te hyrat buxhetore nuk janë realizuar sipas planit për vitin 2018, madje në shumë pozicione ku tek pozicioni i të hyrave licencat dhe lejet ka rënie në raport me vitin 2017 prej 30.45%, pastaj tek certifikatat dhe dokumente zyrtare ka rënie prej 46.89%, tek pozicioni lejet dhe ndërtesat ka rënie 61.51%, mandej te pozicioni të hyrat nga qiraja kemi rënie prej 40.53% në raport me vitin paraprak, tek pozicioni taksat e pronave në raport me vitin 2016 në shumë mbi 500,000.00€, ka rënie në 300,000.00€ për të njëjtën periudhë, andaj rreth kësaj dëshiroj të bëjë pyetje, çka planifikoni të bëni pas dy vitesh kur jemi në dijeni se sa objekti është ndërtuar dhe është rritë mundësia e taksës së pronës. Përfundimisht ky raport shpërfaq mënyrën më të keqe të qeverisjes dhe menaxhimit të parasë publike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, vazhda e keqpërdorimit financiar dhe mjeteve publike po vazhdon, nuk është diçka që nuk po vazhdon sepse të gjithë mund të analizojmë këtë dokument i cili është në gjuhën shqipe dhe besoj i kuptueshëm për të gjithë, por më i kuptueshmi për ta legjitimuar duhet të jetë për Kuvendin si institucion ku vie për pranim të këtij shpenzimi, pra për ne këshilltarët e Kuvendit duhet të jetë më i rëndësishmi e jo për ata që e kanë sjellë tek ne, sepse Ekzekutivi i Komunës e ka sjellë këtë raport në Kuvend që të shikojnë se sa servil, sa lajkatarë dhe sa pavërtetësisht e ngritim dorën ne për dikë i cili nuk na pyet se çfarë të bëjmë, kurse në anën tjetër na sjellin këtë dokument për ta ngritur dorën për vet ata, pra kjo shkon për ata këshilltarë të Kuvendit të cilët e ngritin dorën për një të pavërtetë, nga cilido subjekt politik qofshin. Është gjë e mirë që Drejtori përkatës vazhdimisht po e sjellë në Kuvend një dokument të tillë që paraqet gjendjen reale. Për investime kapitale për vitin 2018 kanë qenë të parapara 6,489,514.00€, kurse tani jemi në fillim të muajit nëntor dhe kanë mbetur edhe një muaj e pak ditë, dhe kemi vetëm 1,859,732.00€ të shpenzuara deri tani, ndërsa mjetet tjera të mbetura sigurisht që do të shkojnë suficid. Gjendjen në Komunën e Podujevës nuk e kemi të kënaqshme për të mos u kryer punë sepse kemi nevojë për të gjitha pothuajse, qoftë për rrugë, kanalizime, subvencione, ndërtime, shërim, kulturë, për shkollimin dhe shkollat, për çerdhe, për mësimdhënës etj, pra për të gjitha

kemi nevojë, nëse jo duhet të deklarohemi. Gjendja aktuale e shpenzimeve prej rreth 50% të buxhetit është dashtë të jetë në muajin qershor e jo tani në muajin nëntor, pastaj çështja tjetër, inkasimi i të hyrave prej 57.8%, sërish po rikthehem tek Drejtori z.Durim Salihu, nga marsi deri tani janë 6 muaj, ju them shumë sinqerisht që po të ishit kryetar ose drejtor i subjektit tim, dhe ti nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit që paguhesh për atë punë, të lejoni të veproni individ të Komunës së Podujevës, jo qytetarët, të veprojnë në këtë mënyrë, përkatësisht të inkasoni vetëm 50%, çfarë t'i thuhet këtij raporti pastaj, jo vetëm raport i dështuar por qeverisje e dështuar. Ky raport nuk i nënshtrohet procedurës së votimit, por është shumë me rëndësi që tregon se çfarë është duke ndodhë këtu, kështu që deri tani në këtë shumën e shpenzimeve prej 1,859,732.00€ më së shumti kanë përfituar vetëm dy kompani të cilat e mbajnë linjën me një njeri, ajo "Toifor" dhe "Bini" ku rreth 90% të kësaj shume ju janë paguar këtyre dy kompanive. Pastaj ka kompani të cilat konkurrojnë por që nuk ju hap derën fare zyrtari i dalë në pension qe 1 vit por që është ndalur nga Kryetari të mbaj atë pozitë të shefit të prokurimit e që në fakt e ka mbyll një vend pune për një person të shkolluar që mund të jetë shef profesional i prokurimit i cili vlerëson si duhet kompanitë të cilat i kryejnë punët, e pastaj paraqesin probleme edhe Drejtorit z.Hamdi Jaha sa i përket asfaltimit dhe ndërtimit të rrugëve pa kurrfarë standardesh, kështu që llogari nuk jep Kuvendi për gjëra të tilla, prandaj çfarë bënë Kryetari që lë një pensioner në pozitën e shefit të prokurimit i cili 1 vit ka marrë rrogë, madje është i pashkolluar, e kam si pyetje për të gjithë, dhe kush është ai person që ia mohon të jetë shef i prokurimit ndonjë personi të ri të shkolluar me mund, sakrifica dhe pa asnjë mbështetje, kur e them këtë kam parasysh që edhe në bursa ka pas tendenca sepse janë eliminuar nga DKA shumë student të dalluar me nota mbi 9.

Kështu që sa i përket këtij raporti sinqerisht ju them se shumë ulët më duket vetja të diskutojmë për gjëra të tilla, aq më shumë kur jemi para mediave, dhe ndoshta më mirë do të ishte të mos silllej fare në Kuvend. Kush jep arsye që dy kompanive t'iu jepen të gjitha punët për të kryer në Podujevë, kush është ai drejtor i cili nënshkruan gjëra të tilla dhe pastaj të kërkohet nga ne të votojmë për. Për gjëra të tilla nuk e arsyetoj askënd, kushdo qoftë ai. Qe dy vite janë duke u mbajtur persona me kontratë mbi veprën nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës, dhe tani ai Drejtor e ka lëshuar krejt vendin e punës kurse ata persona janë ende me kontratë të tillë dhe i mbani pezull. Kjo nuk është qeverisje të nderuar këshilltarë, kjo është shaka me ndjenja të njerëzve, kushdo që e bënë nga cilido subjekt qoftë ai, andaj unë e vërej tek njerëzit se u janë humbë edhe shpresat që i kishin, prandaj ne jemi ata që duhet t'i japim shpresë këtij vendi dhe këtyre njerëzve të Komunës tonë. Mbështetjen tonë e keni si të doni dhe kur të doni për të liruar pronat publike e gjëra të ngjashme. Ende nga ky pushtet nuk kemi ndonjë ndërtesë për banim social, kurse vetëm qe 4 vite e këndeje menaxhohen rreth 100 milion euro, ndërsa kush mund të më thotë se a sheh ndonjë ndryshim në Podujevë nga janari i këtij viti, kurse në anën tjetër e kemi buxhetin e shpenzuar, por asgjë të re diçka, vlen të theksohet se vetëm sa është degraduar pjesa e poshtme e rrugës "Zahir Pajaziti" ku janë prish trotualet dhe nuk kanë të lëvizin qytetarët e as nxënësit të cilët në çdo moment janë të rrezikuar sepse iu duhet të ecin në mes të asfaltit.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, dola sërish për hir të sinqeritetit dhe korrektesisë që dua ta kemi të gjithë. Unë në prezantimin tim të mëparshëm lidhur me raportin financiar janar-qershor 2018 e thash një gjë shumë të qartë se një raport të tillë me specifika të tilla nuk e kanë shumica e Komunave të Kosovës, pra fjala ishte vetëm për një pjesë të raporti e jo për raportin si tërësi. Të falënderoj znj.Doruntinë Hasani që e solle në pah raportin e Komunës së Vushtrrisë, sepse t'ju them të drejtën unë më shumë jam fokusuar në raportet e Komunave që udhëhiqen nga partitë e tjera sepse për ato që udhëhiqen nga Lidhja Demokratike e Kosovës nuk kisha dilema. Kurse sa i përket çështjes që në një far forme u pajtuan edhe dy parafolësit, që kur po analizojmë diçka po

duket sikur po analizojmë dy dokumente të ndryshme, mu kujtua fenomeni i gotës gjysmë të mbushur ose gjysmë të zbrazët, që dua të them se në jetë disa njerëz janë të prirur t'i shohin gjërat vetëm zi, kurse disa shohin edhe ngjyra tjera.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, znj.Fatlume, unë e ceka se LVV është në bashkëqeverisje me LDK-në në Komunën e Vushtrrisë në të cilën Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit është nga radhët e LVV-së.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk po dëshiroj të ngrit replika me askënd aq më pak me ata persona që nuk mund të vendosin vetë, mirëpo e nderuar kolege me gjithë respektin për ty, ti je zgjedhur të mendosh për Podujevë, ashtu siç jemi të gjithë varësisht subjekteve që i takojmë, e jo për Komuna tjera, madje madje përgjegjësia e juaj si këshilltare nga radhët e subjektit që është pozitivë, sepse ne në opozitë fundja atyre që kanë ankesa mund t'ju japim vetëm një arsyetim, ja keni dhënë besimin me vota priteni qeverisjen, pra ne lirohemi nga mos puna e dikujt tjetër. Ngjyra janë të mëdha dhe dallimet e qeverisjes janë të mëdha, por nëse ju e nderuar si këshilltare e Kuvendit merreni përgjegjësi për të arsytuar këtë qeverisje, jam i bindur se do të dështoni, por më mirë është të rrini aty në vend si këshilltare e Kuvendit dhe të ngritni dorën ashtu siç të kanë thënë, pra këtë jua them si kolege sepse pastaj nuk mund të ballafaqohesh me argumente në debate.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, dëshiroj t'ju tregoj se në Komunën e Podujevës nuk janë vetëm dy firma që marrin punë, por shikoni mirë se në dokumentin në fjalë figurojnë 22 firma – operator ekonomik të cilat kanë marrë dhe kryer punë dhe vepronë në Komunën e Podujevë, për investime kapitale dhe për çështje tjera, pra janë mbi 22 të tilla të cilat kanë kryer obligimet e veta sipas kontratave. Çështja tjetër, z.Rafet Llapashtica e ceku se në pjesën e poshtme të rrugës ‘‘Zahir Pajaziti’’ nuk kanë kah të ecin qytetarët, mirëpo i ndërtuar z.Llapashtica, ajo rrugë me plan është ashtu, andaj meqë jam në dijeni se infrastrukturën nuk e njuh ti, dëshiroj t'ju tregoj se tani e tutje secila rrugë do të punohet me tërë infrastrukturën përcjellëse, duke filluar nga heqja – largimi i shtyllave elektrike të cilat vërtetë pengojnë shumë në disa aspekte. Kjo pjesë e rrugës është planifikuar me gjithë infrastrukturën nëntokësore, kanalizimin fekal të cilin një pjesë e kemi kryer etj, mirëpo mund t'ju them se jashtëzakonisht kemi pasë dhe kemi probleme për shkak infrastrukturës nëntokësore që ne si Komunë nuk kemi dijeni të mjaftueshme rreth tyre, madje kemi pas tri raste ku gjatë punimeve është këputur rrjeti elektrik i tensionit të lartë 10 KW dhe për fat nuk ka pasur dëme në njerëz, çështje për të cilën kemi kërkuar ndihmë nga KEDS pothuajse për 3 muaj radhazi me takime dhe biseda, me qëllim të largimit të një pjese të rrjetit nëntokësor por që deri tani nuk ka pasur veprime konkrete nga ana e tyre edhe për kundër premtimeve se do të ndërmarrin veprime konkrete.

Ne jemi duke punuar me një intensitet jashtëzakonisht të madh dhe përveç kanalizimit fekal kemi edhe atë atmosferik, projekt ky i cili është në fazën përfundimtare edhe përkundër asaj që për shkak të problemeve me rrjetin e tensionit të lartë energjetik intensitetit i punimeve është ngadalësuar për rreth 1 muaj e gjysmë, madje për 2 javë është ndërprerë puna ngase është paraqitur rrezik për punëtorët e kompanisë. Pastaj kemi rrjetin e ri të ujësllësit i cili do të vendoset, për shkak se gypat aktual janë azbez-ciment të cilët mendohet se janë shkaktar i disa sëmundjeve, mirëpo të cilët me këtë projekt do të largohen. Pra kemi mbi 36 puseta elektrike, dhe pas mbarimit të kësaj faze, KEDS do të vendos gypin në pjesën e infrastrukturës së Komunës dhe do të ketë një kontratë të shfrytëzimit sipas të cilës KEDS do të paguaj Komunën për shfrytëzimin e asaj pjese të infrastrukturës. Do të bëjmë maksimumin që ajo rrugë të përfundoj dhe t'i hapim mundësi që vitin e ardhshëm të fillohet me ndërtimin e bulevardit të qytetit, dhe këtë e kemi bërë me qëllim që të mos e bllokojmë qytetin duke filluar me disa projekte përnjëherë, mirëpo kemi destinuar mjetet fillimisht për këtë projekt e pastaj të fillojmë me projektin e radhës që është Bulevardi. Sa i përket

asaj që u cek se buxheti për investime kapitale deri tani është vetëm 28%, është shumë reale sepse tani me trendin e fundit që jemi në punime dhe në kryerjen e punimeve dhe pagesave që janë bërë pas këtij raporti, besoj se jemi shumë më mirë, mirëpo ne nuk do të bëjmë pagesa kompanive nëse nuk janë kryer punimet sipas projekteve dhe planifikimeve, por jam shumë i bindur se deri në fund vit punët do të kryhen sipas planifikimeve tona që kemi bërë.

z.Fitim Haziri, theksoi, dua të ndërlihem paksa me parafolësit lidhur me këtë raport financiar, këshilltarja nga radhët e LDK-së e tha se është një raport transparent, mirëpo nëse ndalemi dhe e shikojmë është një raport i cili sjellët gjithëherë i njëjtë në këtë formë ku shembull kemi, asfaltimi i disa rrugëve, meremetimi i rrugëve rurale me zhavorr etj, pra nuk tregohet se cilat janë ato rrugë dhe ne nuk jemi në dijeni për cilat rrugë bëhet fjalë, ndërsa në anën tjetër kemi informacione që ka rrugë që në dokumente figuron se është shtruar 3-4 herë, që është rruga ‘‘Shahredin Bajrami’’ ndërsa ato punime janë kryer vetëm një herë, rrugë për të cilën jemi duke punuar dhe duke përgatitur një kallëzim penal sepse është shkelje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Drejtori parafolës duke mu drejtuar mua e tha se nuk e njeh infrastrukturën, punë të tilla nuk kam punuar asnjëherë mirëpo kur shohë punime e di se çfarë standardi janë ato punime ose punë të kryera. Lidhur me këtë kemi rrugë të cilat janë shtruar 3 herë, pastaj është rruga ‘‘Zahir Pajaziti’’ e cila është asfaltuar në fushat zgjedhore dhe janë bërë pagesat për atë punë, ndërsa në këtë vit sërish e njëjta po priset. Unë jam në dijeni se infrastruktura moderne, me përjashtim të ngrohtores së qytetit që askush njëherë nuk është duke marrë hapa për një gjë të tillë që do të ishte lehtësim për ngrohje dhe mbrojtje e ambientit sepse nuk strategji e as kreativitet Kryetari për të bërë një studim fizibiliteti në mënyrë që të tërhiqen donatorë të ndryshëm, dhe përveç asfaltit dhe kanalizimit nuk ka ide tjera. Pra sa di unë infrastruktura moderne është që nën rrugë duhet të futen, kanalizimi fekal, fibri optik, rryma, gypi i ngrohjes plus dy gypa rezervë për nevoja të Komunës. Pra janë futur gypat në pjesën e rrugës në fjalë dhe është kthyer dheu përkatësisht janë mbuluar ata gypa në dy anët e rrugës, mirëpo nëse dëshironi mund të dalim tani dhe të shohim se a mund të ecin lirshëm ndokush në ato pjesë ku ka punime. Pastaj Drejtori e tha se ne nuk do të bëjmë pagesa nëse punët nuk kryhen ashtu siç themi ne si Komunë, në fakt ashtu është dhe jam në dijeni për këtë sepse punëkryesi duhet të punoj ashtu siç thotë Komuna, dhe jam i bindur se po të ishte i vendosur Kryetari i Komunës, këtu do të punohej siç duhet, mirëpo matematikat i bën ai vet dhe as që diskuton me ju se çfarë të bëjë, kujt t’i jepet puna etj, ndërsa ti si Drejtor i Drejtorisë përkatëse nëse mundesh largoja kompaninë atij që të mos kryej punime, unë e di se nuk mundesh.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, theksoi, sipas raportit në fjalë, nga DSHPMSH janë paguar 734,713.00€, kurse të zotuar në atë kohë kanë qenë 681,938.00€ dhe pjesa tjetër e zotuar kanë qenë për kontrata për fillimin e punimeve etj, ndërsa si do të jetë përfundimi mund ta shohim në të ardhmen, por varet nga shumë faktorë e që nuk është vetëm faktori kohë por ndoshta mund të jenë vonesa nga njësia e kërkesës, nga vlerësimi, nga operatorët etj etj, mirëpo dinamika është duke vazhduar ashtu siç është planifikuar për projektet e infrastrukturës. Kanë qenë 1,366,700.00€ me këto dy pozicione dhe i gjithë buxheti që ka qenë i lirë për zotim është zotuar gjatë muajit tetor dhe besoj se do t’i afrohem maksimumit të shpenzimeve reale për investime kapitale në kuadër të Drejtorisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, mund ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës me një konstatim që koha e mbetur të shfrytëzohet maksimalisht nga Komuna në mënyrë që projektet e parapara të realizohen dhe mjetet buxhetore të shpenzohen maksimalisht sa është e mundur.

4. Propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

Në kërkesë të këshilltarit z.Fitim Haziri, mbështet të mbahet pauzë 1 orë, pas përfundimit edhe të kësaj pike.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, nga KEDS gjatë periudhës dymujore janë parashtruar katër kërkesa për vendosjen e gjashtë trafove në shtyllë të cilat nxënë vend me nga 9 m² dhe një trafo blindë e cila vendoset në një sipërfaqe prej 25 m², trafo të cilat sipas KEDS është vendosur të vendosen në pronë publike-rrugë lokale në lokalitetet e paraqitura në propozim vendimin sipas materialit të dërguar, përkatësisht në zonën kadalstrale Obraçë rr. “Vëllezërit Kastrati”, në zonën kadastrale Dumnicë e Poshtme rr. “Sali Turuçica” dhe rr. “Maliq Dabinoci”, pastaj në zonën kadastrale Balloc rr. “Musë Kaqanolli”, zonën kadastrale Sfeçël rr. “Bejtullah Topanica” dhe rr. “Mehmet Mehana”, mandej në zonën kadastrale Podujevë rr. “Ilir Konushevc”. Pronat të cilat është propozuar t’i jepen në shfrytëzim afatshkurtër 15 vite, pa pagesë, kompanisë KEDS, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t’iu rregullohet cilësia e energjisë elektrike. Në të kaluarën kemi pasë zëra të ngritur përse këto prona po jepen pa pagesë, mirëpo ju njoftoj se disa herë kamë hulumtuar dhe kam gjetur se të gjitha Komunitat e praktikojnë një gjë të tillë, ngase ne në fakt në mandatin e kaluar kemi tentuar të japim prona të tilla me pagesë KEDS-it, por që është refuzuar një gjë e tillë nga kjo kompanie dhe pastaj kemi pasë presion nga qytetarët dhe na është dashtë që të njëjtat prona sërish të jepen në shfrytëzim pa pagesë, gjë të cilën e mundëson Ligji përkatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kërkesa të tilla ne i kemi mbështet në vazhdimësi dhe mendojmë se janë të nevojshme investime të tilla, mirëpo dëshiroj të ngiti një çështje e cila besoj se është ngritur edhe te Grupet tjera të këshilltarëve, kërkesë e cila edhe Ekzekutivi i Komunës duhet ta ketë parasysh për arsye të mungesës së Planit Zhvillimor Urban, për dy trafostacionet që do të vendosen në pjesën e qytetit, në mënyrë që me rastin e zgjerimit të rrugëve të parashihen vendet adekuate të vendosjes së tyre në mënyrë pastaj të mos kemi dislokimin e tyre. Pra e them këtë për arsye se nuk kemi plan të detajuar se si do të duken rrugët në të ardhmen 2019-2024. Kështu që në këtë drejtim është mirë që Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë ta ketë parasysh që me rastin e ndarjes së pronës paraprakisht të konsultohet me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për shkak të distancave në rrugë në zonë urbane, andaj në të ardhmen nëse vie deri te dislokimi, KEDS sigurisht që do të kërkoj mjete financiare për dislokim të trafove.

Çështje tjetër që është shqetësuese nga ana e KEDS dhe që ndokush nga Ekzekutivi duhet të reagoj është se po ndodh të vendosen orët digjitale “top-up” të cilat po vendosen në krye të shtyllave, e që në fakt KEDS po vazhdon inkasimin përmes tri formave, në orët elektrike të vendosura nëpër shtëpi, atë në shtylla dhe kjo e fundit në krye të shtyllave elektrike me të cilën faturohet ose edhe ndërpritet energjia elektrike sikurse forma digjitale e TV-ve, nga qendra me një sistem kompjuterit, e që mendoj se është edhe shkelje e të drejtave të konsumatorit sepse qytetarët asnjëherë nuk do të mund të shohin gjendjen faktike të shpenzimeve por vetëm do të pranojnë faturën të cilën pastaj nuk do të mund të shohin në orë sa kanë harxhuar apo është inkasim i dhunshëm nga KEDS.

Jam në dijeni se për vendosjen e orëve në krye të shtyllave disa Komuna e kanë ndërprerë, andaj edhe në Komunën e Podujevës është mirë të ndërpritet ngase KEDS për një gjë të tillë duhet të paraqesë kërkesë në Komunë për këtë çështje dhe për çdo veprim të punës që e bënë, për arsye se lejet i jep Komuna – Drejtoria përkatëse, pra nuk jemi për të dirigjuar KEDS-in se si bënë

inkasimin e mjeteve, por jemi të diskutojmë dhe ti themi Kryetarit që kur të sjellën kërkesat të ndryshme nga KEDS, ta diskutojë edhe çështjen e vendosjes së orëve në krye të shtyllave elektrike, sistem i cili nuk është as i rregulluar me ligj por edhe është shkelje e të drejtave të konsumatorit, prandaj të diskutojmë a mundemi apo jo ta stopojmë një gjë të tillë e që është edhe kërkesë e shumë qytetarëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se është e rrugës që të diskutohet kjo çështja e vendosjes së orëve elektrike në krye të shtyllave elektrike sepse nëse ka raste të tilla konsumatorët nuk kanë qasje dhe kjo duhet të rishikohet.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, është mirë që Kuvendi i Komunës së Podujevës vazhdimisht ju ka dhënë prona në shfrytëzim kompanisë KEDS për vendosje të shtyllave dhe trafave elektrike me qëllim të përmirësimit të rrjetit të energjisë elektrike, dhe si shpërblim i kësaj KEDS ka bërë mjaftë investime dhe vetëm në këtë vit që jemi janë bërë mbi 7 milion euro investime dhe për vitin e ardhshëm janë të planifikuara 5.6 milion euro, do të thotë se jemi prej komunave të para që do të përfundoj komplet rrjeti energjetik më së largu deri në vitin 2022.

Sa i përket vendosjes së orëve në shtylla elektrike, në krye të tyre, ne do të trajtojmë dhe do të sqarojmë me përfaqësues të KEDS-it këtë çështje përse ndodh një gjë e tillë.

Pas votimit u konstatua se me 25 votë për, 8 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua propozimi i vendimit dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

Pauzë, (ora 12:00)

Pas pauzës prej 1 orë, mbledhja rifillon në ora 13:00, konstatohet kuorumi ku të pranishëm ishin 33 anëtarë të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit fton të marrë fjalën hyrëse Drejtorin e Drejtorisë përkatëse

5. Propozim vendim për caktimin e lokacionit me destinim për deponimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, pas një hulumtimi në terren që kemi bërë në nivel të drejtorëve të katër Drejtorive kemi ardh në këtë përfundim se si vende më adekuate për deponimin e mbeturinave ndërtimore janë lokacionet e propozuara sipas dokumentacionit të këtij materiali, e që nga ana e Kuvendit kërkohet të miratohen me vendim lokacionet përkatëse. Jemi përcaktuar për këto dy lokacione për arsye se në të njëjtat gjendja është degraduese deri në atë masë ku parcela në fshatin Llaushë është një gropë e madhe që është bërë si pasoj e nxjerrjes së dheut dhe materialit guror si dhe në kohën e luftës ai lokacion ishte shfrytëzuar nga forcat serbe si barrikadë, dhe tani ai vend është shndërruar në një mini-liqen me ujë të ndotur nga i cili mund të paraqitet rrezik për banorët e atyre fshatrave përreth duke mos përjashtuar as bigëtit në ato pjesë. Kjo parcelë është bukur larg vendbanimeve dhe është e përshtatshme për një destinim të tillë.

Gjithashtu kemi edhe lokacionin në fshatin Sallabajë, për të cilin mund të them se kemi hasur në deponi faktike në të cilën veç kishte material ndërtimor të deponuar. Caktimi i këtyre lokacioneve

ka qenë edhe kërkesë e aksionit në nivel vendi, Ta pastrojmë Kosovën, drejtuar Komunave të Republikës së Kosovës, e që pastaj janë krijuar task-forcat në nivel komunal, ku ndër çështjet kryesore që u janë kërkuar Komunave janë: identifikimi i numrit të deponive ilegale me mbeturina dhe caktimi i lokacioneve për deponi inerte, pika të cilat janë kritere kryesore për të qenë përfitues të granteve të Qeverisë e cila ka ndarë mbi 1 milion euro, që do t'iu ndahet 5 komunave më të suksesshme, e që ne do të tentojmë dhe punojmë të jemi njëra prej këtyre 5 komunave. Andaj të ndërtuar, bëj apel që për arsye e lartcekura, të pranoni këtë propozim dhe me votën tuaj ta shndërroni në vendim të Kuvendit të Komunës.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, gjatë vizitave në terren dhe bisedimeve me banorët e fshatrave përkatëse, Sallabajë dhe Llaushë, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kemi ardh në përfundim lidhur me qëndrimin tonë sa i përket kësaj pike të rendit të ditës. Fillimisht në fshatin Sallabajë kemi vizituar vendin ku parashihet të ndërtohet ajo deponi, ndonëse pa ndonjë vendim të Kuvendit të Komunës në atë lokacion tani veçse kishte filluar të grumbulloheshin materiale ndërtimore dhe përveç këtij materiale kishte filluar të grumbulloheshin edhe mbeturina komunale. Banorët e asaj zone janë shqetësuar për këtë fakt sepse sa herë që ka erëra në fshat përhapet një erë e pakëndshme e cila vie si rezultat i mbeturinave komunale të cilat do të thotë se veç kanë filluar të grumbullohen në atë kodër dhe po ashtu ku ka erëra të fuqishme bartet edhe materiali.

Lokacioni në këtë fshat është tejet i gabuar, grumbullimi i materialit në fjalë nuk duhet të bëhet në vende kodrinore por është mirë që ai material të shfrytëzohet për mbulimin e gropave të ndryshme në Komunën tonë që shpeshherë paraqesin rrezik edhe për banorët, me këtë rast nga një punë do të realizoheshin dy punë të mira. Arsyeja tjetër pse nuk duhet të ndërtohet deponi e tillë në atë lokacion tek rr. "Ruga e Gurit" është për arsye se ka shumë shtëpi afër atij lokacioni, madje shtëpia më e afërt është rreth 200 m, në vijë ajrore dhe varion deri në 600 m, dhe do të ishte shumë e rëndë që atyre banorëve t'iu grumbullohet material ndërtimor në derë të shtëpisë. Se ky propozim është tejet i gabuar mund të vërtetohet shumë lehtë sepse së pari nuk keni marrë fare në pyetje banorët e atij fshati lidhur me këtë çështje, madje nuk keni pyetur as ekspertët sepse nuk keni qenë të aftë të bëni studimin e pronës para se të merret vendim për lokalizimin e deponisë në fjalë, me këtë deponi do të pengoni bigëtit për kullosa, do të shkatërroni këtë tokë me pasuri nëntokësore të cilën edhe ekspertët e kanë vërtetuar se kjo kodër e quajtur "Ruga e Gurit" përmban nikel që është një xehe e shtrenjtë, pastaj do të rrezikoni cilësinë e ujërave minerale që burojnë kudo në atë vend dhe ujërave termominerale me të cilat njihet ajo zonë ku dihet se rreth 1 km larg gjendet edhe banja shëruuese. Me këtë deponi po ia humbisni vlerat atij fshati i cili përkundrazi do të duhej të shpallet vend me rëndësi të veçantë, ndërsa në anën tjetër banorët e fshatit Llaushë kategorikisht e kundërshtojnë ndërtimin e deponisë në fshat dhe duhet kuptuar dhe respektuar kundërshtimin e tyre sepse për atë sa keni vërejtur rreth 10 m, larg asaj parcele ndodhet një tokë punuese ku tash së fundmi mendohet të ketë pasur grurë të mbjellur, por fundja a nuk është e tepërt që përveç deponisë së mbeturinave komunale që ndodhet në fshatin Dumnice e Epërme, asaj zone t'i shtohet edhe një deponi për grumbullimin e materialit ndërtimor. Ne përveç që e kundërshtojmë fuqishëm dhe japim votën kundër këtij propozimi, kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, të mendohet edhe njëherë mirë se ku do të ishte e përshtatshme të vendosen këto deponi në mënyrë që të mos përsëritet i njëjti gabim që është bërë para ca kohësh në fshatin Orllan për vendosjen e impiantit të ujërave të zeza, për shkak të planifikimit jo të mirë, prandaj kërkoj mbështetjen e kolegëve dhe dakordim mes shefave të Grupeve të këshilltarëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne edhe në KPF kemi diskutuar për dy lokacionet për deponi të materialeve inerte, e që është e vërtetë se Komuna jonë nuk ka deponi të tilla dhe lokacione të caktuara për një gjë të tillë, mirëpo në anën tjetër është një obligim që Komuna duhet të ketë deponi

për mbeturina inerte për arsye se ato materiale nuk mund të hudhen në deponitë për mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina tjera të ngjashme. Drejtori i DPKGJ në fjalën hyrëse e sqaroi dhe arsyetoi caktimin e dy lokacioneve përkatëse për dy deponi për mbeturina inerte, e që unë besoj se ndoshta për një qëllim të tillë do të duhej të ishin 4 deponi të tilla. Sa i përket propozimit për dy lokacionet në fjalë është e vërtetë se të paktën debat publik me banorët e atyre fshatrave nuk është mbajtur, ndërsa ka ankesa prej banorëve të cilët jetojnë afër atyre dy lokacioneve, pastaj është e vërtetë se mbeturina inerte nuk barten nga erërat apo elementët tjerë të natyrës, mandej është e vërtetë se në lokacionin në fshatin Sallabajë është një fushëgropë në të cilën akumulohet ujë dhe ndoshta edhe janë hedh edhe mbeturina të ndryshme por që me grumbullimin e mbeturinave inerte ai vend do të rrafshohet. Nga këshilltarja parafolëse ishte një propozim që kjo pikë të shtyhet dhe të mbahet një debat me banorë, dhe në këtë aspekt mendoj se banorët që janë afër nuk pajtojnë kurse ata që janë më larg nuk di si mund të veprojnë por që janë shumicë, ndërsa ishte edhe propozimi tjetër që një lokacion i tillë të hiqet nga fshati Sallabajë dhe të caktohet në ndonjë fshat tjetër, e që mendoj se sërish do të paraqiten probleme sepse pastaj mund të thonë ata përse po heqni prej atij fshati e po e sjellni tek ne. Mendoj se jemi paksa në një situatë që ndoshta na duhet ta shqyrtojmë pozicionin tonë për arsye se për një gjë të tillë parashihen edhe donacione për Komunën tonë ashtu siç e ceku Drejtori i DPKGJ. Në fakt është mirë që edhe një kërkesë të një qytetari duhet ta marrim parasysht dhe ta shqyrtojmë në këtë mes ku jemi, edhe pse nuk jam në dijeni të plotë se si ka shkuar komunikimi me ata banorë para se ky propozim të sjellët në Kuvendin e Komunës, përndryshe konsideroj se të gjithë në këshilltarët e Kuvendit nga të gjitha subjektet duhet të japim mendime dhe propozime për lokacione për mbeturina inerte. Ne jemi për dy deponitë në fjalë si dhe ndoshta edhe për rritjen e lokacioneve të tilla në 4 pole ashtu siç e ceku në KPF Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mënyrë që mos të barten mbeturina të tilla shembull nga Dumnica në Sallabajë, por të caktohen në 4 pole në mënyrë që ndërtuesi apo rrënuesit e objekteve ta kenë sa më afër bartjen e tyre. Sa i përket lokacionit në Sallabajë t'ju them të vërtetën në mbledhjen e KPF-së kemi qenë për, që kjo pikë të sjellët në Kuvend të diskutohet dhe të jepet përkrahja që të jetë një deponi e tillë për pjesën perëndimore të Komunës, por edhe shqetësimet e cekura nga parafolësja znj. Lirika Maliqi, mendoj se janë reale. Unë kam biseduar me disa banorë të asaj ane dhe nga ata që jetojnë në pjesën e poshtme nuk janë aq kundër por ata që jetojnë afër atij lokacioni po janë kundër, mirëpo ajo parcelë është një fushëgropë e cila do të rrafshohet dhe do të mbushet dhe pastrohet nga ato ujëra të zeza si dhe të evitohet rreziku për fëmijë, siç ishte rasti i mbyrtjes së dy fëmijëve në territorin e Komunës së Prishtinës para disa viteve. Pra edhe nëse nuk mbushen me materiale inerte është mirë të rrafshohet ajo fushëgropë. Kështu që ne tani si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së disi po mbetemi si neutral, edhe pse ndoshta është mirë të merr fjalën edhe njëherë Drejtori i DPKGJ të na jap sqarime shtesë rreth propozimit për lokacion në fshatin Sallabajë, a është mbajtur debat me ata banorë e gjera tjera të ngjashme, edhe pse jam i mendimit se Komuna nuk mund të mbetet peng i mospajtimit të një numri 5-6 të vogël të banorëve.

z. Avni Islami, theksoi, ka rreth 5-6 seanca më parë kur unë si përfaqësues i subjektit politik Balli Kombëtar Demokratik e kam ngritur çështjen e deponisë në fshatin Dumnicë e Poshtme ku sot e asaj dite ka probleme serioze me atë deponi për të cilën jam në dijeni se janë përpjekur edhe përgjegjësit komunal që të ndikojnë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, por që çështja e asaj deponie nuk është zgjedhur, por jo që është problem vetëm i banorëve të fshatit Dumnicë por është problem më i madh që tejkalon edhe Komunën e Podujevës ngase nga ajo deponi rrjedhin kimikale të cilat përmes lumit Dumnica derdhen në lumin Llap. E ritheksova këtë çështje për shkak se ky problem ka mbetur i pazgjidhur, kurse tani kemi një propozim për deponi të materialeve të ngurta, me theks në atë zonë e që në hapësirë nuk është larg nga deponia që e

ceka, do të doja nga ata persona që janë përgjegjës të na japin edhe sqarime shtesë në mënyrë që ta dimë se sa është shkalla e rrezikshmërisë për banorët përreth si dhe a lirohen rrezatime apo diçka e ngjashme që ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e qytetarëve afër atyre deponive, andaj sa i përket kësaj pike edhe nëse shtyhet për ndonjë mbledhje të radhës nuk do të paraqiste ndonjë problem.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, meqë në kuadër të Drejtorisë që unë jam drejtor është edhe pjesa e ambientit, gjë për të cilën unë decidivisht jam për mbrojtjen e ambientit. Ne fillimisht së bashku me Drejtorët tjerë përkatës kemi vizituar lokacionet në të cilat kemi menduar paraprakisht që duhet të vendosen për deponi për mbeturina inerte dhe kemi analizuar shumë në këtë drejtim e që shumë herë është përfolur që fshati Shamalluk është i përshtatshëm për deponi të tillë i cili pastaj ka dal të jetë një gjelbërim i shkëlqyeshëm dhe me një rrjedhje të ujit. Sa për njoftim për deponinë ekzistuese në fshatin Dumnicë e Poshtme e cila është ndërtuar në vitin 2002 unë kam qenë kundër sepse nuk është ndërtuar sipas standardeve, jo kundër lokacionit apo vendosjes së saj, edhe pse kanë qenë mjete financiare të mjaftueshme për një gjë të tillë, donacion nga BE-ja, pra kam qenë shumë i ashpër në atë kohë, por që ne si Komunë nuk kemi mund ta ndërtojmë një të tillë sepse MMPH e ka pasë përsipër, dhe me rastin e pranimit teknik të asaj deponie ne kemi marrë mostrat dhe kemi dërguar drejtpërdrejt në laborator e që nuk kanë rezultuar me rezultate të mira, mirëpo pastaj sipas tyre janë bërë përmirësime, dhe kësaj MMPH e ka bërë pranimit teknik të asaj deponie, andaj edhe sot mendoj se ndoshta nuk është në nivelin e duhur ajo deponi. Sa i përket dy lokacioneve të propozuara për deponi të mbeturinave inerte, fillimisht me atë në fshatin Llaushë me shumë përgjegjësi ju them se ajo parcelë duhet të mbyllet gjithsesi sepse është një gropë jashtëzakonisht e madhe dhe duhet të mbyllet, pastaj ne si Komunë pasi të jetë mbyllur ajo gropë do të shtrojmë një shtresë me dhe cilësor dhe të gjelbërojmë atë hapësirë, ashtu siç do të veprojmë edhe me lokacionin në fshatin Sallabajë, duke mos përjashtuar edhe dy lokacione tjera në dy pole tjera të cilat duhet ti caktojmë pas një kohe. Andaj ju preferoj që të votoni këto propozime sepse është çështje emergjente për shkak se materialet inerte janë duke u hedhë në pjesë të ndryshme të territorit të Komunës së Podujevës, nëpër qoshe të rrugëve gjë për të cilën mendoj se jeni në dijeni se nuk mund të bëjmë kushedi çka ne si Komunë sepse ka persona të atillë që edhe pas mes nate i hedhin mbeturinat në fjalë, kështu që është mirë dhe ju ftoj të votoni këto dy propozime dhe pastaj të shohim bashkërisht me Ju edhe për dy lokacione tjera.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne si LVV edhe në mbledhjen e KPF-së e ngritëm shqetësimin tonë rreth këtyre lokacioneve për deponi të mbeturinave inerte, pastaj dëgjova me vëmendje arsyetimin e Drejtorit parafolës dhe më erdhi mirë për gatishmërinë që tregoj që bashkërisht me asamblistët të caktojnë lokacione të tilla në të ardhmen, mirëpo kam pyetje, përse nuk keni pasë një gatishmëri të tillë para se të merrni një vendim për këto dy lokacione. Meqenëse për fshatin Sallabajë pretendohet diçka që ne nuk jemi ekspert dhe madje as në nivel Kosove nuk është bërë ndonjë hulumtim për shpimin e tokës se çfarë burimesh, qoftë në aspektin mineral qoftë ujqor që mund të ketë në atë vend, por që banorët pretendojnë se në atë vend ka hekur dhe nikel, por që ne jemi në dijeni se burim të ujit mineral ka, gjithashtu edhe ujë termik, andaj meqë ka pretendime të tilla është mirë të mos ngutemi dhe të marrim vendim pa u sqaruar më në detaje, asgjë nuk bëhet që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër ku paraprakisht diskutojmë dhe vizitojmë bashkërisht dhe në fund vijmë me një qëndrim unik, gjë që do të ishte e mirë për Komunën tonë, pra mos të ngutemi.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolësit, theksoi, i nderuar këshilltar ende nuk është marrë vendim për këtë çështje andaj edhe është sjellë për diskutim dhe shqyrtim ku edhe po e bëjmë një gjë të tillë. Pra është vetëm propozim.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, po foli në cilësinë e Koordinatorit të Task-forcës, Grup apo komision ky që është ngritur në të gjitha Komunat e Kosovës, në bazë të preferencës së Qeverisë së Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Nuk është shumë me urgjencë por megjithatë unë do t'ju inkurajoja që këtë çështje ta shqyrtojmë shumë seriozisht sepse ky aksion përfundon me 15 dhjetor 2018, datë kjo që deri më atëherë Komunat duhet të kenë lokacion të caktuar për vendosjen, deponimin dhe mirëmbajtjen e mbeturinave të ngurta apo siç quhen inerte. Në komision e kemi diskutuar se ku do të mund ta bëjmë deponimin e materialeve inerte në territorin e Komunës së Podujevës. Vlen të theksohet se deponia e mbeturinave në fshatin Dumnicë e Poshtme është deponi rajonale, jo e Podujevës. Ndërsa për mbetjet e hedhura për të cilat këshilltarja e nderuar znj.Lirika Maliqi e tha se janë mbetje komunale, nuk është mirë të cilësohen me këtë shprehje sepse ato mund të jenë mbetje të cilat janë hedhur nga individ të papërgjegjshëm.

Pra pas analizës së bërë në komision, mendojmë se në territorin e Komunës së Podujevës nuk kemi ndonjë hapësirë të lirë, pronë publike ku do të mund të bënim një deponi të madhe që do të mund të absorbonte të gjitha mbetjet inerte, por fillimisht të vendosim për dy deponi më të vogla derisa të gjejmë edhe zgjidhje tjera në mënyrë që t'ju afrojmë edhe atyre operatorëve dhe atyre individëve privat me rastin e rrënimëve të shtëpive dhe diçka e ngjashme, andaj jemi munduar të bëjmë një zgjidhje të përkohshme për këtë fenomen shumë të dëmshëm për ambientin dhe në këtë kontekst duhet ta kuptoni që ne po japim një kontribut që ta përmirësojmë dhe ta ruajmë ambientin e jo ta dëmtojmë atë. Çështje tjetër, lokacionet e propozuara janë me shkallë të lartë të rrezikshmërisë për banorët, në veçanti për fëmijët, por edhe për kafshët, pra janë gropa të pa mirëmbajtura, të mbushura me ujë andaj ne jemi përcaktuar që fillimisht këto dy pika të zeza t'i mbyllim njëherë e përgjithmonë, përkatësisht t'i mbushim me mbetje të ngurta e pastaj kur të mbushen dhe nuk kanë kapacitet absorbues më, do t'i rehabilitojmë me mbjellje të gjelbërimit dhe drunjtëve. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë pikërisht për ato dy vendbanime, përndryshe ne mund t'i lëmë ashtu siç janë, duke u thirr në arsyetime të ndryshme, por të jeni të bindur se në ato lokacione gjendja nuk do të ndryshohet, përkundrazi vetëm sa do të vështirësohet, pra nëse ne si Komunë i marrim nën menaxhim ato dy lokacione atëherë dihet adresa e përgjegjësisë kurse kështu siç janë vazhdimisht hudhen mbeturina të ndryshme qoftë inerte qoftë të amvisërisë dhe vazhdon e njëjta situatë atje. Unë besoj se zgjidhja më e mirë është që sot të miratohet ky propozim për dy lokacionet përkatëse e pastaj të mendojmë edhe për lokacione tjera, duke shkuar me logjikën e eliminimit të pikave të rrezikshme e mandej në të ardhmen të mendojmë të kemi ndonjë deponi komunale për menaxhimin e mbeturinave inerte. Për fund, nëse deri më 15 dhjetor 2018 ne si Komunë nuk kemi ndonjë vendim për caktimin e së paku një lokacioni për mbeturina inerte, atëherë mund të marrim poena negativ në renditje të këtij projekti të Qeverisë e që deri më tani jemi prej Komunave të para me pikë për shkak të eliminimit të shumë deponive ilegale të mbeturinave të ndryshme.

Mbështetet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit për një pauzë të shkurtër.

Pas pauzës, Kryesues i Kuvendit fton njërin prej shefave të Grupeve të prezanton qëndrimin rreth kësaj pike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, gjatë kësaj pauze ne shefat e Grupeve të këshilltarëve biseduam rreth propozimeve për dy lokacione për deponi inerte në fshatrat Sallabaj dhe Llaushë, propozimi është që të formohen të dy deponitë inerte në këto fshatra me një përgjegjësi të Ekzekutivit të

Komunës që pas mbushjes dhe rrafshimit të atyre gropave me materiale inerte, të mbulohen me një shtresë të dheut me një trashësi të paraparë sipas normave të ambientit dhe pastaj mundësisht të gjelbërohen ato vende në mënyrë që ato pjesë të bëhen sikurse që janë pjesët tjera të natyrës që janë afër tyre. Pra ato fushëgropa të mbyllen, të eliminohet rrezikshmëria për fëmijët dhe për kafshët – bagëtitë, dhe pas mbushjes në nivel të tokës, të rrafshohet me dhe, si dhe të bëhet gjelbërim-pyllëzim. Ky propozim bëhet edhe për faktin që menaxhimin e këtyre dy deponive do ta merr Komuna, do të ketë mbikëqyrje, si dhe të eliminohen hedhjet e mbeturinave inerte në vende të ndryshme madje edhe skaj rrugëve. Kështu që nëse ndokush nga Ekzekutivi i Komunës del dhe merr përgjegjësi këtë që e ceka, do të ishte mirë në këtë seancë të thotë një gjë të tillë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, ashtu siç biseduam, Komuna do të merr përgjegjësi të plotë që pas mbushjes së këtyre dy gropave aktuale që janë me mbetje inerte dhe të propozuara për deponi për një gjë të tillë, të bëjë rrafshimin, mbulimin me një shtresë të caktuar të dheut dhe pastaj ato dy lokacione të pyllëzohen me mbjellje të drunjtëve në mënyrë që t'i kontribuojmë ambientit. Pra me vendimin e Juaj për caktimin e këtyre dy lokacioneve për deponi të materialeve inerte do të eliminohet edhe rreziku i mundshëm që në ato vende të ketë ndonjë viktimë ashtu siç ka ndodh në disa raste në vende tjera të Kosovës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne shefat e Grupeve të këshilltarëve biseduam paraprakisht mes vete dhe ne si LVV shprehëm shqetësimet tona lidhur me këtë propozim vendim dhe njëkohësisht insistuam që caktimi i lokacionit për deponi të tillë në fshatin Sallabajë të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, andaj duke marrë parasysh të gjitha argumentet dhe arsyetimet e paraqitura, mbetet që secili këshilltar/e nga radhët e LVV-së të vendos vetë ashtu siç ata vetë dëshirojnë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa kuptova paraprakisht nga këshilltari paraprak i cili mori fjalën në emër të shefave të Grupeve pas një diskutimi që patët mes vete, ishte se për këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar është arritur unitet, mirëpo nga këshilltari parafolës pati qëndrim paksa të ndryshëm, por si do që të jetë nuk paraqet ndonjë problem dhe është qëndrim i juaji, andaj vazhdojmë me punë.

Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, 3 vota kundër dhe 6 vota të përmbajtura të përmbajtur, u miratua propozimi i vendimit për caktimin e lokacionit me destinim për deponimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore.

6. Propozim vendimi për shpallje interes publik (ndërtimi i rrugë përgjatë brezit të lumit Llap në Qytet)

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, duke u mbështetur në dispozitat përkatëse të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ne si Drejtori kemi propozuar këtë propozim vendim, materialin e të cilit besoj se e posedoni të gjithë, andaj vetëm por dëshiroj të jap disa sqarime dhe arsye shtesë rrethë këtij propozimi. Është interes publik i cili në Planin Zhvillimor Komunal nuk është komplet e paraparë si rrugë, njëkohësisht me Planin Zhvillimorë Urban është vetëm një pjesë e rrugës e paraparë, do të thotë ashtu siç ka qenë rruga më parë, ndërsa sipas ligjit, për shpalljen interes publik të atyre pjesëve të parcelave ne jemi të obliguar të sjellim në Kuvendin e Komunës për miratim të këtij vendimi për shkak se është interes publik. Rruga në fjalë është filluar në vitin e kaluar dhe shpresojmë që brenda 10 ditëve do të përfundoj komplet, pastaj është rrugë e cila ka një qasje të mirë për qytetin e Podujevës sepse mund të cilësohet si një lloj unaze

apo gjysmë unaze për qytetin. Për shpronësimin e pronave sigurisht jemi në dijeni se kompetente është Ministria e Financave – Departamenti për shpronësim, e cila bënë vlerësimin e pronës. Ne si Komunë kemi të drejtë të vendosim në njërin prej tri varianteve, varësisht cilën e zgjedhim në bashkëpunim me pronarët, zgjedhja e parë është ajo e cila duhet të dërgohet në Ministrinë e Financave për shpronësim e që para vetës keni edhe listën e pronave për secilin person duke u cekur edhe hapësira e cila i merret secilit pronar, pastaj kemi variantin e dytë që është këmbimi i tokës por që bëhet në bazë të vlerësimit të vlerës së tokës që merret dhe që jepet, si dhe është mundësia e tretë e cila për Komunën është shumë e mirë, variant sipas të cilës për pjesën e shpronësuar, komuna i jep ose kompenson në ndërtim, do të thotë aq sa i merret i lejohet në ndërtim, ndërsa Komuna nuk ka obligim në kuptimin financiar ndaj asnjërit prej pronarëve, por ka obligim në leje të ndërtimit për ata pronar të cilëve iu merret pronë. Kështu që unë ju lus që ky propozim vendim të miratohet për shkak se janë procedurat tjera të cilat mundësojnë ecjen më tutje, si dhe për faktin që rruga është veç se në përfundim.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor i DPUMM, neve na u dha një propozim i cili edhe na është dërguar me e-mail mirëpo unë gjatë takimeve që kam pasur me banorët e lagjes të cilët nga mëngjesi kanë ardhur dhe të cilët i kemi maltretuar për të na dëgjuar neve për punë të cilat nuk janë të tyre por janë punë tonat. Banorët në fjalë kanë shpreh një shqetësim ku sipas tyre diçka kanë ndërruar fjalët mes tyre dhe Komunës, pra unë po flasë në bazë të banorëve të cilët janë këtu prezent, të cilët po ashtu kanë bërë një petition-kërkesë në adresë të Kuvendit komunal të cilën mund ta adresojmë ose tek Ju Drejtor, ose tek Nënkryetari apo edhe tek Kryetari i Komunës. Si pikë e rendit të ditës, nuk e them të kthehet në pikën zero, por mendoj se do të ishte mirë të rishqyrtohej edhe njëherë, për shkak se sipas banorëve janë ndërruar fjalët sa i përket shpronësimit apo kompensimit që kanë qenë mes Komunës dhe banorëve, andaj për të mos i ngarkuar të tjerët, do të ishte mirë që ne, nga pozita, opozita dhe Ju Drejtor të caktonim një takim me ata banorë në mënyrë që të shohim se si janë mundësit që të dalim nga kjo situatë sepse me këtë që e potencuat ata banorë nuk janë të pajtimit me asnjë formë, dhe nëse nuk merret ndonjë hap lidhur me këtë, unë nga këtu ftoj të gjithë këshilltarët e Kuvendit të votojnë kundër kësaj pike ose mund ta pezullojmë deri në seancën e radhës.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, i drejtohet parafolësit, theksoi, unë desha të jap sqarime dhe shpjegime vetëm në aspektin ligjor andaj mund ta merrni ligjin dhe ta shikoni, prezent këtu janë qytetarët me të cilët ne kemi biseduar, andaj atyre nuk mund t'iu japim as më pak as më shumë se sa që parashihet me ligj. Pastaj ata banorë as për 1m² nuk do të jenë të hendikepuar që Komuna do t'iu merr pronë në pronësi të tyre. Pra unë e thash në aspektin ligjor se cilat janë të drejtat e Komunës e cila ka planifikuar për një rrugë e cila është në Podujevë dhe është interes publik i kësaj Komune, çështja e parë që jam i obliguar ta them para juve, është shpronësimi ose vlerësimi i pronës për shpronësim të cilin nuk e bënë Komuna por është niveli qendrorë përkatësisht organi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, dhe ai i Ministrisë së Financave, pastaj është çështja e dytë që ka të bëjë me këmbim të tokës sipas të cilës nëse toka këtu vlen, shembull 100,000.00€ unë propozoj një tokë tjetër të cilat pastaj vlerësohen ku sërish shembull, nëse dikund merren 1 ari, ta zëmë, jepen 50 ari varësisht vlerësimit, mirëpo ne kemi marrë modelin më të mirë sipas meje që është se ne si Komunë ju japim pronarëve të pronave leje ndërtimi, që ata pranojnë, në kuadër të pjesës ku ne kemi marrë, është leje në ndërtim të lartë, të mesëm dhe të ulët, pjesë e cila ende nuk është pozicionuar me hartën zonale e cila besoj se deri në muajin mars do të dalim me draftin e parë i cili do të sjellët në këtë Kuvend dhe pastaj sipas planifikimeve që kemi deri në muajin qershor do të përfundohet komplet harta zonale dhe do të sjellët për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, dokument në të cilën do të përcaktohet për secilën parcelë në territorin

e Komunës së Podujevës, për destinimin (tokë bujqësore, ndërtimore, biznesore etj etj). Me banorët pronar të atyre pronave ne kemi biseduar dhe në këtë aspekt dëshiroj të jap shpjegime që nëse ndokujt i merren ta zëmë 2 ari dhe ai person ka 20 ari, në certifikatën për marrjen e lejes i ka prap 20 ari, pra vetëm i rritet koeficienti i ndërtimit në atë pjesë, model ky i cili është më i mirë për ata banorë por edhe për Komunën në një formë sepse ka praktika të mira të këtij modeli që edhe Komuna e Prishtinës e aplikon, pra për të mos marrë mjete financiare sepse po të fillojmë të ndajmë mjete financiare për shpronësim do të kemi pastaj shumë raste të tilla e që pothuajse gjysma e buxhetit do të shkoj vetëm për shpronësim për të rregulluar infrastrukturën, kështu që nuk ka asnjë dilemë për qytetarët tanë, nuk iu merret pasuria ashtu siç mund të ketë qejf Komuna sepse janë ligjet të cilat e rregullojnë këtë fushë dhe nuk ka shans teorike ata të dëmtohen qoftë edhe për 1m² nuk dëmtohen ata pronarë, çështje të cilën e kemi diskutuar edhe më parë, mund ta diskutojmë sot por edhe do ta diskutojmë edhe në të ardhmen sepse unë jam i obliguar për t'jua them këtë. Po të ishte e paraparë ajo rrugë në Planin Zhvillimor të Komunës - PZHK, ne si Ekzekutiv do të zhvillonim procedurat e parapara me ligj dhe nuk do të sillej këtu në Kuvend fare kjo çështje, por përderisa nuk është në PZHK dhe nuk ka qenë as në Planin Urbanistik komplet si rrugë ne kemi qenë të obliguar të sjellim në Kuvend në mënyrë që ajo pjesë përkatësisht ato pjesë të pronave që preken nga rruga të shpallen interes publik dhe t'i hapet rrugë procedurave tjera ligjore, pra kjo është arsyeja.

z.Vendenis Lahu, theksoi, na ka ardh si propozim vendim për shpallje në interes publik pjesët e ngastrave ku është duke u ndërtuar rruga e cila siç e kemi parë të gjithë është vetëm në përfundim e sipër, ndërsa tani na ka ardh ky propozim vendimi për miratim në Kuvend, e që kjo realisht i bie që rruga në fjalë është ndërtuar në pronë private e që sigurisht, nuk po di por ndoshta ka pas ndonjë marrëveshje gojore me banorët aty apo cilado ka qenë, pastaj nuk di a ka pasë ndonjë debat publik me banorët pronar të atyre ngastrave që merren për ndërtimin e rrugës e që realisht mendoj që është dashtë të ketë debat publik dhe të diskutohet për këtë çështje, por si duket nuk ka pasë debat të tillë. do të thotë se kjo rrugë po ndërtohet me qëllim që të hapet qyteti dhe të ndërtohet sheshi në rrugën kryesore "Zahir Pajaziti", por nëse realisht e shikojmë atë rrugë kapaciteti i saj është goxha i ngushtë dhe nuk e di sa mund ta përballoj fluksin e automjeteve dhe atë të mobilitetit që do të ketë e që nuk di se a ka ndonjë plan të mobilitetit sipas të cilit do të përcaktohej që sa parashihet të ketë qarkullim në atë rrugë sepse nëse qarkullimi në atë rrugë do të jetë sa ai i rrugës "Zahir Pajaziti" unë nuk di se si do të mund të funksionoj për shkak se kapaciteti i saj është dukshëm më i vogël e që mendoj se do të ketë probleme edhe për shkak se lidhet edhe me rreth rrotullimin tek udhëkryqi në drejtim të Kërpimehut i cili është shumë i ngarkuar, pastaj në realitet proceduralisht nuk ka shkuar me rregull dhe me rend sepse fillimisht është dashtë të bëhet propozim vendimi dhe shpronësimi e pastaj të ndërtohej rruga. Pra këto janë vërejtjet tona sa i përket kësaj çështje.

z.Arbër Blaku, theksoi, pika apo forma e tretë që Drejtori i DPUMM e propozoi, sipas të gjitha gjasave edhe banorët janë të pajtimit, kështu që prezent këtu jemi rreth 34-35 këshilltarë të Kuvendit e që në një formë jemi dëshmitar të asaj që Drejtori e tha se deri në muajin mars do të kemi draftin final të hartës zonale, e që rrjedhimisht përcaktohet edhe çështjet e dhënies së lejeve ndërtimore etj të ngjashme, e që unë pajtohem me këtë dhe iu besoj shumë dokumenteve si dhe këta po pajtojnë, mirëpo uroj të mbahen këto fjalë dhe të veprohet ashtu.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, ekziston edhe një Ekstrakt i procesverbalit nga takimi i atyre qytetarëve të asaj lagjeje me Kryetarin e Komunës dhe stafin e Tij qysh në fillim të inicimit të çështjes që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës në fjalë. Çështje tjetër është ajo që unë e thash se në hartë zonale do të përcaktohen të gjitha llojet e parcelave, shfrytëzimi i tyre dhe çështje tjera të

ngjashme për secilën pjesë – ngastër në territorin e Komunës së Podujevës, rregulla për të cilat do të jemi pastaj strikt sa i përket respektimit të tyre, kurse tek pjesa e parcelave në fjalë, banorët pronar të tyre kanë kërkuar që në të ardhmen kur të fillojnë ndërtimet në atë pjesë Komuna të mundëson lëshimin e lejeve ndërtimore sipas kërkesave të atyre pronarëve, andaj kjo çështje rregullohet me hartë zonale, e që unë mendoj se ajo pjesë-zonë do të jetë më atraktivja në qytetin e Podujevës, madje nëse bëjmë krahasime mund të them se do të jetë si “Rruga B” në Prishtinë, pra asaj pjese do t’i jepen hapësira për biznese dhe zhvillim ekonomik në përgjithësi. Pra asnjë shqetësim tjetër nuk kanë nevojë të kenë banorët e asaj lagjeje.

z.Avni Islami, theksoi, i nderuar Drejtor i DPUMM, kërkoj të kemi edhe një sqarim shtesë për të gjithë ne këtu duke përfshirë edhe banorët pronar të pronave që preken nga ndërtimi i rrugës, pra u përmend një marrëveshje, andaj pyes, a ekziston marrëveshje, a është e bazuar në ligje, a ka garancion, a është në formë të shkruar dhe si do të bëhet kjo.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, edhe njëherë dëshiroj t’ju sqaroj se ne nuk mund të veprojmë në kundërshtim me ligjin sepse prona apo pjesë të e tyre nuk mund të merren askujt vetëm pse dikush ka dëshirë ose vetëm pse jemi Komunë në këtë rast, mirëpo janë ligjet të cilat përcaktojnë si duhet të vepohet në procedurë. Kur kemi të bëjmë me interes publik, është Kuvendi i Komunës ai i cili jep pëlqime, nëse jo çështjet nuk mund të zhvillohen tutje, qoftë në aspektin ekonomik, qoftë në infrastrukturë qoftë në plane rregullative, buxhetore etj etj, por besoj se të gjithë jemi në dijeni se kur kemi të bëjmë me interes të përgjithshëm për qytetarët, siç është rasti në fjalë që kemi të bëjmë me ndërtim të infrastrukturës dhe zgjerim të qytetit ngase ajo pjesë pothuajse nga vitet 50-ta ka mbet në atë gjendje, andaj ne po dëshirojmë t’i japim zhvillim asaj pjese të qytetit, aq më shumë kur kemi të bëjmë anën e kundërt të lumit, pra kjo është arsyeja që ne dëshirojmë dhe do ta zhvillojmë atë pjesë, dhe në këtë aspekt besoj që nëse ata banorë-pronar kanë ide se çfarë të bëjnë, lejet në Komunë do t’i marrin brenda kohës së paraparë me ligj, dhe për këtë unë nga këtu ju garantoj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, vërtetë është kontradiktore kjo çështje, dhe po kthehem sërish tek raporti i auditorit të përgjithshëm, i nderuar Drejtor i DPUMM, të thuash që për rrugën në fjalë nuk kemi Plan Zhvillimor të Komunës, nuk kemi Plan Urbanistik, nuk kemi hartën zonale, do të thotë se administrata komunale po ngarkohet shumë sepse është filluar një punë pa u kryer të gjitha fazat përgatitore për të filluar një projekt të tillë, ne sigurisht që jemi në dijeni se është në interes të qytetarëve por edhe në interes të atyre banorëve pronar të atyre pronave, mirëpo në tri mundësit e kompensimeve që u përmenden duhet të ketë marrëveshje me shkrim sepse tjera forma nuk janë të besueshme, madje edhe për hartën zonale që u tha se përgatitet deri në muajin mars nuk është shumë e besueshme, por megjithatë po të isha unë në vend t’juajin ose të Kryetarit të Komunës do të bëja edhe një urë ndërlidhëse me rreth rrotullimin e cila do të dilte bukur për qytetin, por jo pa u kryer procedurat ligjore paraprake që janë ato për shpronësim për të cilin u tha se janë në kompetencë të Ministrisë së Financa e ku ta di unë mirëpo sigurisht bëhen në bazë të propozimeve dhe dokumentacioneve t’juaja që përgatitni dhe i dërgoni, por kjo është praktikë jo vetëm në Komunën tonë por edhe në nivelet tjera ku planifikimet bëhen me vonesë dhe shpeshherë pastaj ndodhin gjëra të ndryshme ku rasti konkret është Drejtori e thotë se nuk kemi Plan Zhvillimor, Plan Urbanistik, hartë zonale për të cilën u tha se do të bëhet deri në muajin mars e që për mendimin tim është utopi, ndoshta po gaboj.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, i nderuar z.Bajram Ajeti, Komuna e Podujevës e ka Planin Zhvillimor Komunal të miratuar në vitin 2016, por rruga në fjalë nuk figuron rrugë në atë Plan, por është vetëm një pjesë e saj, andaj ne jemi të obliguar me ligj që të sjellim në Kuvend për miratim në mënyrë që pjesa tjetër e rrugës të shpallet interes publik – strategjik për Komunën dhe

qytetarët, pastaj Komuna e Podujevës e ka edhe Planin Rregullues Urban por që ajo rrugë nuk figuron, mandej e kemi edhe Planin Detaj Urbanistik për atë zonë, mirëpo ne tani me hartën zonale e cila është duke u përgatitur edhe me ndihmën e GIZ Gjerman, kemi planifikuar që në muajin mars të përgatitet drafti i parë dhe pastaj planifikojmë që deri më 01 qershor 2019 të sjellët drafti final në këtë Kuvend të Komunës. Pra këto që i cekta janë shpjegime për parafolësin, për të cilin kam menduar që nuk i nevojiten shpjegime të tilla sepse ka jetuar në Zvicër si një shtet shumë i fuqishëm, dhe njihemi mes vete e që kam menduar se vetëm pse unë e them një gjë të tillë ai do të duhej të thoshte se ashtu është.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Drejtori i DPLUMM i sqaroi format e shpronësimit të një prone private e cila kalon – shpallet interes publik e që ne padyshim e kuptojmë se është interes publik zhvillimi i infrastrukturës. Ne tani jemi mes dy dilemave sepse, në bazë të informatave që kemi, një pjesë e atyre qytetarëve pronarë të atyre pronave janë për, por është edhe pjesa tjetër janë kundër. Drejtori në fjalë vetëm ka sjellë këtë propozim kurse vendimin e merr Kuvendi i Komunës. Ne më së paku jemi të interesuar t'i bllokojmë ata qytetarë, edhe pse nuk jemi në dijeni se çfarë kanë biseduar me Drejtorin, mirëpo ne jemi këtu për t'ju lehtësuar atyre punën edhe pse në takimet që ka zhvilluar Drejtori i DPUMM me ata qytetarë ne nuk kemi qenë të ftuar, por që ne jemi për të zhbllokuar situatën sepse ndërtimi i asaj rruge është pengesë derisa të merret vendimi për shpronësim, a ka qenë gabim procedural po, sepse ndërtimi i rrugës është në përfundim, prona tani del se është uzurpuar në një mënyrë ngase punimet janë zhvilluar kurse shpronësimi nuk është bërë. Problemi është se qytetarët duhet të ndiejnë një siguri në institucion, dhe vetëm një gjë po e sqaroi për të gjithë, institucionet shtetërore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë si dhe Ministria e Financave e cila është një prej titullarëve të shpronësimit që bënë kompensim me mjete financiare për m², për bazë i merr normat e çmimit në zonat 1 dhe 2 në qytetin e Podujevës, eventualisht edhe të ndonjë marrëveshje me shkrim që bëjnë palët kontraktuese, dhe në këtë rast Kuvendi i kësaj Komune apo unë si këshilltarë i Kuvendit ose ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK, të themi se po e bëjmë shpronësimin në fjalë, asnjë garancë nuk është këtu nga ana e Komunës, por vetëm thuhet fjalë ku Drejtori i cekur e tha se do t'ju japim lejen për ndërtim, mirëpo çka nëse me hartë zonale ajo pjesë nuk parashihet ndërtim i lartë atëherë çka bënë Komuna pastaj ose çka bëjnë ata qytetarë, do të thotë se nuk ka siguri 100% askush se ajo pjesë do të parashihet ndërtim i lartë sepse Komuna nuk ka ende plan strategjik dhe ende nuk e ka kaluar në ndërtim atë pjesë të qytetit dhe nuk ka ende hartë zonale dhe plan zhvillimor afatgjatë ku do të përcaktoheshin se cilat zona do të jenë ndërtim i lartë, pra kjo është me rëndësi që ta dinë qytetarët që janë prezent këtu dhe t'ju shpjegohet edhe atyre që nuk janë prezent që nuk ka siguri që Drejtori i DPUMM do t'ju lëshoj lejet për ndërtim të lartë në të ardhmen, po nëse ju jap ai siguri ne të gjithë po e ngrisim dorën dhe po votojmë për. Pastaj çështja tjetër, kompensimin dhe çmimin nuk e caktojnë qytetarët, por nëse miratohet në Kuvendi dhe zhvillohen procedurat tjera çmimin e cakton dikush tjetër dhe për atë çmim pastaj marrin qëndrim ata qytetarë. Për këtë çështje është dashur të mbahet debat publik dhe të ishim prezent edhe ne si këshilltarë të Kuvendit. Pastaj nëse qytetarët pronarë të pronave përkatëse nuk pranojnë këtë shpronësim, puna ndalet në gjysmë dhe nuk mund të vazhdohet me punime edhe pse disa shpenzime janë bërë nga ana e Komunës sepse punët kanë filluar dhe është kontrata për atë rrugë – projekt, kontratë e cila duhet të përfundoj sepse në të kundërtën janë penalltitë financiare për institucionin e që në këtë rast operatorit duhet t'i paguhet shuma sipas kontratës nga ana e Komunës për fajin e vetë Komunës.

Drejtori i DPUMM e tha se krejt në rregull është dhe do t'ju lëshoj lejet e ndërtimit etj etj, mirëpo unë ju drejtohem juve qytetarë se asnjë dokument nuk ekziston që juve ju sigurohet kompensimi apo lëshimi i lejes së ndërtimit, madje as Drejtori nuk mund të jap një premtim të tillë sepse nuk

mund t'iu siguroj, prandaj lus të mos hedhet në votim ky propozim vendim edhe pse LDK ka shumicën dhe mund të kaloj këtë me vota, por në emër të subjektit të PDK-së – dega në Podujevë, për hir njerëzore kërkoj të bëhet një ekip e përbashkët duke përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit, Drejtorin e DPUMM e të tjerë, të takojmë secilin pronarë të atyre pronave që preken nga rruga në fjalë dhe të marrim qëndrimet e tyre, pse jo edhe pëlqimet e tyre, në të kundërtën ne jemi në dijeni se pronat a tyre private askush nuk mund t'jua merr, andaj i nderuar Kryesues për hir të transparencës është mirë të shtyhet kjo pikë deri të arrihet një pëlqim i atyre qytetarëve dhe pastaj me një mbledhje të shpejt mund ta shqyrtojmë sërish duke u dakorduar të gjitha palët dhe ne si këshilltarë të Kuvendit, dhe pastaj në dhjetor ose janar të merret vendimi ashtu siç dakordohen Komuna dhe ata pronarë të pronave në fjalë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, sa i përket temës, ne po debatojmë për diçka që është e precizuar me ligj, dhe nuk mund të marrim ndonjë akt këtu që të rregullojmë ne kompensimin në raste të tilla, sepse kjo është e rregulluar me ligj. Kushdo që thotë se do të bëjë këtë ose atë, është më pak e rëndësishme, ligji i rregullon çështjet të tilla, prona private nuk tjetërsohet pa procedura dhe pa eksproprijim dhe kompensim, kështu që të jeni të sigurt të gjithë duke përfshirë edhe qytetarët pronarë të atyre pronave që janë prezent këtu, që asnjë m² e pronës tuaj që do të merret – shpallet interes publik, nuk do të merret vetëm ashtu, por do të kompensohet, kurse mënyrën e kompensimit do ta caktojme së bashku me Ministrinë e Financave përkatësisht me komisionin për vlerësimin e pronave, ndërsa shumën e kompensimit ne nuk mund ta dimë sepse nuk është kompetencë e jona dhe këtë e bënë një komision i ngritur nga Ministria e Financave. Që nuk do të merret apo shpronësohet asnjë m² pa kompensim, këtë jua them me garancë të plotë, por për formën se si do të kompensohet është më së miri të merren vesh pronarët e pronave bashkë me neve si Komunë që jemi edhe realizuese e projektit për të mirën publike, dhe komisionin vlerësues të pronave, kështu që nuk po e shohë shumë të arsyeshme që të bëhen diskutime rreth nxjerrjes së ndonjë rregulloreje, vendimi etj, sepse nuk mund të nxjerrim akte të tilla, por vetëm mundemi që të marrim vendim për shpalljen të atyre hapësirave interes publik.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, vetëm dëshiroj t'ju njoftoj se tani sapo është bërë edhe përkthimi i një toke dhe ka dal në emër të 5 pronarëve të rinj, pra për këtë ka mund të jetë edhe një ndër shqetësimet e banorëve por që tani është zgjidhur kjo çështje me këtë përkthim, dokument i cili nga tani është edhe pjesë e propozim vendimit përkatësisht listës së bashkëngjitur në propozim vendim, sepse ka qenë vetëm një parcelë dhe ajo është parcelizuar në 5 emra pronarë, fjala është për Jetullah Hajdari, Hajdar Hajdari, Ismajl Hajdari, Rexhep Hajdari dhe sërish Jetullah Hajdari. Pra edhe njëherë ju përsërisë se ky dokument që ju është sjellë është vetëm propozim vendim me të cilin kërkohet që ato pjesë të pronave të shpallen interes publik, kurse procedurat tjera të mëvonshme janë ato për të cilat diskutuam dhe që nuk po e shohë të arsyeshme t'i ripërsërisë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Nënkrjetar, ligji e specifikon shumë qartë këtë problem, në anën tjetër, ashtu siç është përcaktuar me ligj, ju jeni kundër ligjit ngase pronat përkatëse fillimisht duhet të kalojnë me vendim të Kuvendit të Komunës e pastaj të fillohet me punime, pra nuk ka guxuar asgjë të preket në terren pa u marrë vendimi për shpallje në interes publik. Pra ligji e përcakton se fillimisht duhet të shpallet interes publik, pastaj forma e kompensimit të shpallet në gazetë zyrtare dhe të nënshkruhet nga Qeveria sepse në nivel lokal nuk mund të rregullohet kjo çështje. Drejtori i DPUMM e tha se kemi marrëveshje me qytetarë, kurse unë pyes në bazë të cilit ligj bëhet marrëveshje private me qytetarë, por edhe të jetë marrëveshje legale ajo nuk guxon të jetë në kundërshtim me ligjin. Ligji nuk e lejon të fillohen procedurat e punimeve, madje as tenderuese për prona private, pa u zhvilluar procedurat e shpronësimit dhe të del në gazetë zyrtare e nënshkruar nga niveli qendrorë për aspektin financiar, kurse në nivelin lokal nuk ka person i cili

e zbaton ligjin dhe siguron dikë që në një pjesë të caktuar siguron se do të jap leje për ndërtim të lartë, madje as Kryetari i Komunës nuk mund të siguroj askënd për gjë të tillë, ndërsa çfarë ju thonë në takime unë ju siguroj se nuk është ashtu fare.

z.Arbër Blaku, theksoi, konsideroj se ne si Kuvend patjetër duhet të marrim një përfundim sepse vetëm po bëjmë debate të kota. Sa po kuptoj unë edhe nga banorët pronar të atyre pronave por edhe nga diskutuesit e deritanishëm, kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet patjetër për një seancë tjetër të radhës. Nuk ka kurrfarë marrëveshje të nënshkruar me ata banorë pronarë të atyre pronave, kurse ata banorë nuk iu besojnë fjalëve më, ngase sipas tyre që dy vite janë në bisedime me përfaqësues të Komunës dhe tani më ata banorë nuk iu besojnë fjalëve të Komunës, kështu që edhe njëherë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës së Kuvendit, ose ose nëse Komuna bënë marrëveshje me ata banorë pronarë të atyre pronave, nesër apo pasnesër, ne jemi të gatshëm të mbajmë seancë, pa kompensim ditor, dhe të vendosim për këtë çështje për shkak se është një e mirë e përgjithshme. Pra kjo pikë të shtyhet deri sa të bëhet një marrëveshje me shkrim mes Komunës dhe pronarëve të pronave në fjalë.

z.Avni Fetahu, theksoi, të nderuar kolegë, por edhe ju qytetarë prezent që jeni në sallë, të paramendojmë për 10 apo 20 vitet e ardhshme që për çdo lagje të caktuar të diskutojmë kështu sikurse sot duke shprehur preferenca se kujt dhe çka i konvenon diçka, mirëpo shumë qartë e tha Nënkyetari i Komunës se gjëra të tilla rregullohen me ligj, nëse Ekzekutivi i Komunës zotohet se nuk do të humb asnjë edhe një pëllëmbë atyre banorëve, unë nuk di çfarë marrëveshje tjetër është e nevojshme. Nëse ne fillojmë të kërkojmë ose të bëjmë me çdo lagje marrëveshje për gjëra të caktuara, atëherë i humb kuptimi kësaj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, mirëpo paraprakisht e hedh në votim propozim vendimin sipas materialit të dërguar dhe materialit shtesë që Drejtori i DPUMM e paraqiti gjatë kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se është qëndrim njëzëri i këshilltarëve të Kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje të radhës, me rekomandim që sipas mundësive sa më shpejt të arrihet ujdi mes Komunës dhe pronarëve të pronave që preken nga ky projekt, dhe kurdo që jemi të gatshëm ne si Kuvend mund të thërrasim një mbledhje dhe të votojmë këtë propozim vendim.

7. Propozim vendimi për ridestinimin e objektit “Pushimorja për fëmijët bonjak” në fshatin Orllan

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë propozim vendim për ridestinimin e objektit të pushimores për nxënës dhe fëmijë bonjak të mbetur nga lufta e fundit në Kosovë, objekt i cili është ndërtuar me mjete financiare të UFORK, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës, Punimet për të cilin kanë përfunduar në vitin 2010, është një objekt i cili ka rreth 1700 m² dhe përbëhet nga 17 dhoma, 2 salla për konferenca, kuzhinë, sallë të restorantit, hapësirën për ngrohje si dhe ka të rregulluar edhe infrastrukturën e jashtme. Me një Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, objekti në fjalë është dhënë në pronësi dhe menaxhim të Komunës së Podujevës.

Propozim vendimi në fjalë është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL 2016/2018, ku në pikën 1.4 nënpika 1.17 të kësaj Strategjie thuhet, citoj, deri në fund të vitit 2017 bëhet funksionalizimi dhe ridestinimi i objekti, Pushimorja për nxënës dhe fëmijë jetim,

në fshatin Orllan. Arsyeja e ridestinitimit të objekti të cekur është për shkak të arritjes së moshës madhore të atyre për kë ka qenë i dedikuar ai objekt. Me SZHEL në fjalë është paraparë që ky objekt të ridestinohet për nevojat e zhvillimit ekonomik të Orllanit me rrethinë, fshat ky i cili siç jemi në dijeni të gjithë, ka resurse të zhvillimit ekonomik i cili drejtpërdrejt ndikon edhe në zhvillimin e blegtorisë, fushë kjo e cila në atë pjesë të Komunës është ndër më të zhvilluara. Me vendimin e datës 10.05.2013 Kuvendi i Komunës së Podujevës ka marrë vendim për dhënie në shfrytëzim të objektit të cekur, me destinimin e paraparë për nxënës dhe fëmijë bonjak të mbetur nga lufta, pastaj Komisioni përkatës për tri herë radhazi ka shpall njoftimin publik por që asnjëherë nuk kemi pasë të interesuar për të marrë në shfrytëzim këtë objekt me destinimin përkatës, andaj kjo është edhe arsyeja që duke u mbështetur në SZHEL të kërkojmë nga Kuvendi të bëjmë ndërrimin e desitnimit të objektit në fjalë.

z.Avni Fetahu, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së konsiderojmë se ridestinimi i objektit në fjalë, i hapë rrugë komisionit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, të hartoj kritere të qarta konform ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi duke iu dhënë mundësi investitorëve potencial që ta shfrytëzojnë atë potencial që kemi ne si Komunës në atë zonë dhe me këtë të krijohen të hyra për Komunën e Podujevës, por mbi të gjitha realizimin e punësimeve të banorëve të asaj ane. Meqë është fazë e ridestinitimit, unë e konsideroj se shumë më e rëndësishme është që Komisioni i cekur të hartoj kritere të veçanta, t'i respektoj parimet bazë që janë: Parimi i ligjshmërisë, parimi i efikasitetit, parimi i trajtimit të barabartë të palëve që konkurrojnë për atë pronë, parimi i transparencës, parimi i ruajtjes së vlerës së pronës komunale dhe mbi të gjitha parimi i ruajtjes së mjedisit. Nëse respektohen këto parime të qarta që janë në kuadër të ligjit dhe aktit nënligjor përkatës për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, sigurisht që do të ketë investitor shumë seriozë dhe potencial që ta zhvillojnë atë pjesë.

z.Fitim Haziri, theksoi, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë ka paraqitur para Kuvendit një propozim vendim për ridestinitimin e objektit, pushimorja për nxënës dhe fëmijë të mbetur bonjak gjatë luftës së fundit në Kosovë, me një ridestinitim objekt afarist hoteleri – shëndetësi. Arsyeja e këtij ridestinitimi e cekur në këtë dokument është se fëmijët bonjak të luftës tani janë rritur dhe më nuk janë fëmijë, është e pabazuar, dhe për këtë është mirë që Nënkryetari i Komunës të jap një sqarim rreth kësaj çështje. Të gjithë e dim se ku gjendet objekti në fjalë i cili është ndërtuar në vitin 2005, e jo në 2010 ashtu siç e ceku Drejtori i DPKGJ, kostoja e ndërtimit të atij objekti kap shifrën rreth 800,000.00€ i financuar nga UFORK, Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Podujevës dhe ka ato hapësira që u cekën në fjalën hyrëse nga Drejtori por ka edhe një pishinë e cila është e papërfunduar ende, dua të them se është një vend piktoresk. Një objekt si ky buzë liqenit të Batllavës si një vend shumë i bukur shumë kush do të kishte dëshirë ta ketë nën menaxhimi, por ja që fati e deshi që Komuna jonë të menaxhohet nga njerëz të padijshëm të cilët asnjëherë nuk mendojnë t'i shfrytëzojnë projektet në interes të qytetarëve të Komunës por vetën në interes të tyre personal. Tani më kanë kaluar 14 vite që kur është përfunduar objekti në fjalë dhe Kryetari i Komunës nuk ka ditur se si ta funksionalizoj, madje për këto vite nuk ka dituar as të jap përgjigje. Paramendojeni që bëhet fjalë për një objekt i tillë i përfunduar qe 14 vite dhe që nevojitet vetëm inventarizimi, me të vërtetë kur një njeri nuk dinë është keq, por me ditë që nuk dinë kjo është edhe më keq e kësaj i thuhet injorancë e dyfishtë. Çfarë kanë humbur qytetarët e Komunës së Podujevës nga mos funksionalizimi i objektit në fjalë, nëse do ishte funksional ky objekt, të paktën 40 persona do të ishin të punësuar që do të thotë se 40 familje llapjanë do të kishin një pagë mesatare rreth 350,00€ e cila në mënyrë direkte do të përmirësonte mirëqenien e tyre, pra për 14 vite ato familje kanë pasur mundësi të përfitojnë mbi 2 milion euro, pastaj çka ka humbur Orllani me fshatrat përreth, ne jemi dëshmitar se si jeta në viset rurale është vështirësuar nga mos

investimet nga ana e pushtetit lokal dhe ai qendror ku banorët e atyre anëve po detyrohen dita ditës që të shpërngulen dhe të shkojnë në vende tjera për një jetë më të mirë. Sikur objekti në fjalë të ishte funksional, banorët atyre fshatave prodhimet e qumështit dhe ato të mishit do të kishin mundësinë t'i shisnin tek kjo ndërmarrje. Kur është fjala për mos funksionalizim kemi edhe objekte tjera në Komunën e Podujevës të cilat janë ndërtuar dhe nuk janë funksionalizuar, kemi Çerdhen e cila tani e 16 vite është ndërtuar dhe vazhdon të mbetet në atë gjendje, pastaj ndërtesa e kryqit të kuq e cila qe 9 vite ka mbete në atë gjendje që është, kush duhet të marrë përgjegjësi për këto ndërtesa. Orllani me rrethinë është vend turistik dhe vizitohet nga qytetarë të të gjitha vendeve të Kosovës, është një pikë strategjike për zhvillim ekonomik dhe Komuna duhet të mendoj mirë dhe të planifikoj edhe investime të tjera në këtë vend që do të rigjeneronin të ardhura për Komunën e Podujevës të cilat do mund të rialokonin në projekte të ndryshëm të cilat do të përmirësonin jetën e qytetarëve të Komunës tonë. Ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, propozojmë që ky objekt të ridestinohet në një ndërmarrje publike në pronësi të Komunës ku do të mund të punësoheshin dhjetëra qytetarë të Komunës së Podujevës e që veprimtaria e asaj ndërmarrje të ndikoj në të mirën e përgjithshme të qytetarëve. Ky objekt propozojmë që të shërbej si pushimore për fëmijë dhe nxënës bonjak, pushimore për sportistë, restorante dhe dhoma që do t'ju shërbej qytetarëve që përmes tyre të krijoj të hyra kjo ndërmarrje si dhe t'i shërbej edhe institucioneve lokale dhe atyre qendrore për organizimin e trajnimeve dhe konferencave të ndryshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në fakt objekti në fjalë është në pronësi dhe menaxhim të Komunës, mendoj se nuk ka nevojë të bëhet tjetërsim atij objekti andaj edhe jam që ai objekt të ndalet dhe të jetë në pronësi të Komunës ashtu siç është. Tjetërsimi i destinimit të objektit në fjalë i cili ka qenë i ndërtuar nga UFORK, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Komunës së Podujevës në vitin 2004/5 dhe i destinuar për fëmijët bonjak por që asnjëherë nuk është shfrytëzuar nga kjo kategori dhe asnjëherë kjo shtresë e shoqërisë nuk ka arritur të hap derën e atij objekti, për arsye se asnjë Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS deri tani nuk ka shikuar se ku janë kjo kategori e personave dhe ajo shtresë e fëmijëve bonjak, madje jam shumë i sigurtë që asnjë Drejtor i Drejtorisë së cekur dhe as Kryetari i Komunës nuk posedojnë një regjistër të kësaj kategorie të qytetarëve të kësaj Komune, e them këtë sepse po të kishte një regjistër të tillë deri tani njëherë do të ishte vizituar ai objekt të paktën për relaks të atyre fëmijëve, e që mendoj se kjo është më shumë se turp për përgjegjësit të cilët kanë pas për obligim ta bëjnë këtë punë ngase ai objekt ka qenë shumë funksional, madje ashtu siç u cek i njëjti ka sallat, shtretërit, dhomat, kuzhinën dhe ambientet tjera, por mendoj se ka munguar vetëm që Drejtori i DSHMS t'i merr regjistrat dhe t'i thotë fëmijëve bonjak se jeni të ftuar, dera është e hapur nga NN data, gjë të cilën nuk e ka bërë asnjëri deri tani. Çështje tjetër, objektet buzë liqenit të Batllavës janë duke u rrënuar edhe tani ku një pjesë e tyre tani veç janë rrënuar dhe nganjëherë rrënimet që ndodhin në bazë të ligjeve dhe për mbrojtjen e ambientit si dhe reflektimi prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë mu ka dukur si reflektim selektiv ngase kanë çka të rrënojnë objekte si në Brezovicë, si në Bogë, si në Prevallë, si në mes të Prishtinës, por kanë ardhë direkt në Orllan por që asnjë deklaratë nuk ka qenë prej Komunës së Podujevës në funksion të shqyrtimit të atij problemi edhe pse ka qenë i vështirë sepse në një formë edhe ata kanë zbatuar një pjesë të ligjit për mbrojtjen e ambientit, mirëpo reflektim nuk ka pasë. Edhe gjatë rrënitit ka pas selektim të rrënimeve në atë pjesë dhe kjo është shumë e vërtetë. Materialet inerte të rrënimeve deri më tani, e që sa jam në dijeni në muajin nëntor do të filloj faza e dytë e rrënimeve në bazë të planeve që ka Ministria e cekur e që deri ku do të vazhdojnë me rrënime ata e dinë, pra ai material inert hedhet në lumin e Batllavës përball shkollës së këtij fshati e cila është ndërtuar shumë afër lumit për të mos thënë "në lum", pra janë hedh ato materiale mbi disa gropa që sipas zyrtarëve të asaj Ministrie

që e kanë bartë atë material kanë thënë se Komuna na ka thënë kështu dhe ne vetëm po e bartim këtë material ndërtimor nga rrënimi i objekteve, nëse nuk është ashtu dikush duhet të del të demantoj këtë në të kundërtën mendoj se nuk është në rregull të bëhet degradim i dytë të ambientit, madje afër shkollës së re për ti mbyllur disa gropa, do të thotë në një anë e pastrojnë, në anën tjetër e dëmtojnë ambientin kurse qytetarët të dëmtuar. Pastaj është shumë e vërtetë që në atë zonë është bërë edhe tjetërsim i parcelave nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtori z. Abaz Llugaliu e din më së miri, janë marrë parcelat prej Herticë në Baraina, nëse jeni të interesuar jua them edhe kujt i është ardh ajo parcelë, është bërë krim me pronën, sepse nga Hertica është ardh parcela në Baraina në plazhin numër 5 dhe nëse jeni të interesuar jua them edhe emrin e personit kujt i është qitë ajo parcelë, mandej problem tjetër është se përballë plazhit numër 5 janë tjetërsuar 16 hektar e 80 ari pronë po nga ky kadastër dhe ka pasë proces gjyqësorë për të cilin Drejtori i cekur e ka vendimin sipas të cilit KEK ka fituar pronësinë, ngase ajo pronë ka qenë publike kurse disa parcela ju janë qitë në emër të disa personave, pra 16.80 hektar pronë e KEK janë tjetërsuar dhe janë bartur në emër të personave privat mirëpo pastaj pas një procesi gjyqësorë ato prona ju janë kthyer sërish KEK-ut me vendim. Në plazhin numër 5 Drejtori z. Abaz Llugaliu ja ka qitë pronën në emër të Agim Ademit tani Kryetar i FFK-së dhe kjo është shumë e vërtetë që parcela nga Hertica është sjellë në Baraina, nëse nuk është kështu Drejtori mund ta demantoj dhe pastaj shkojmë në MMPH dhe në KEK dhe e sqarojmë këtë çështje qoftë edhe me pronarin e viles aty, që e përmenda. Problemi tjetër është se sa jam në dijeni unë është një donacion Evropian prej 35 milion euro për investime në Liqenin e Batllavës për ndërtimin dhe ngritjen e digës në Orllan dhe Batllavë për rritjen e nivelit të akumulimit të ujit, projekt ky i fituar nga niveli qendror dhe sa unë jam i informuar, nëse ngritja e digës bëhet për 3 metra, për objektin që ne po diskutojmë sot për t'ia ndërruar destinimin dhe t'ia japim ndokujt me qira, do ta merr uji deri në katin e tretë. Pastaj sa unë jam i njoftuar, me hapjen e zhvillimit të atij projekti, një pjesë e shkollës së re është e ndërtuar në pronë të KEK e që z. Abaz Llugaliu e dinë këtë edhe më mirë se ne sepse kemi të bëjmë pothuajse me gjysmën e shkollës. Problemi tjetër është se Stacioni i Policisë, objekti i ri i shkollës dhe çdo objekt i ri i ndërtuar buzë liqenit do të rrënohet, në bazë të planit zhvillimor nacional. Komunës së Podujevës mendoj se shumë shpejt do t'i dalin detyra të reja edhe për shtëpitë e komunitetit Ashkalinj dhe një pjese të Shqiptarëve në atë zonë për t'iu bërë zgjidhje të pronës për banim sepse siç e thash atë hapësirë do ta mbuloj uji me rastin e ngritjes së digës, dhe sa jam i njoftuar shkolla e mesme e Orllanit do të vie tek ajo e Batllavës afër objektit të ri të shkollës, pastaj do të bëhet komplet rrethimi i liqenit të Batllavës dhe nuk do të ketë askush qasje në atë hapësirë. Pastaj në atë zonë është shkuar një donacion Evropian prej këtij Kuvendi ku kanë qenë afër 200 - 300 mijë euro tek plazhet e Orllanit (te plepat), dhe donatori ka thënë se përgjegjësinë për këtë investim e merr Ekzekutivi i Komunës, investim të cilin unë e quaj, investim në arë të huaj, sepse është bërë investimi janë ndërtuar plazhet madje me shtretër e çadra dhe pastaj këtë e bllokoj ligji dhe ne mbetëm të bllokuar kurse ajo shumë e mjeteve pothuajse shkoj huq, andaj përgjegjësia është e dikujt. Tani kemi të bëjmë me tjetërsimin e objekti në fjalë e që mendoj se Komuna e Podujevës duhet ta lë atë objekt ashtu siç është pronë Komunale. Dëgjova nga dikush që tha se ka salla të cilat mund të shfrytëzohen për konferencave etj të ngjashme, dhe unë mendoj se qysh tani ne si Kuvend i Komunës mund të shkojmë ta hartojmë planin e punës së Kuvendit për vitin 2019 sepse salla është e gatshme deri sa atë objekt ta rrënoj MMPH. Pra ai objekt është i Komunës dhe ashtu duhet të mbetet, nuk duhet të shfrytëzojmë momentin kohorë 2-3 mujor për shkak se i kanë mbyllur objektet hoteliere dhe tash të mendojmë të hapim atë objekt veç se është buzë ujit, duke menduar se tani kemi lidhje dhe të bëjmë diçka sepse atyre tjerëve ju janë mbyll, mandej destinimi duhet të jetë deri diku një plan ashtu si është aktualisht, është shumë e vërtetë se

ata fëmijë që kanë mbet bonjak tani janë rritur dhe kanë 19 vite, mirëpo ka fëmijë tjerë të shumtë që janë bonjak, ka nëna mbajtëse të familjes si dhe ka nevojë Komuna e Podujevës të mos shkoj në salla tjera për gjëra të ndryshme por ta shfrytëzoj atë objekt. Pra jam që ai objekt të mbetet pronë komunale dhe ai objekt të shfrytëzohet për interesa të Komunës si dhe eventualisht për shfrytëzimin e asaj shtrese për çka edhe janë dhënë mjetet financiare.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, pyetje konkrete për Drejtorin e Drejtorisë përkatëse, përse gjatë gjithë mandatit të kaluar ne kemi shtruar pyetje se kur do të hapet dhe çka do të bëhet me objektin në fjalë dhe asnjëherë asnjë përgjigje të vetme si dhe asnjë sqarim eventual nuk na është dhënë nga e Juaj Drejtor.

Çështja tjetër, a do t'ju kompensohet banorëve të asaj zone të cilët kanë pasur zeje (teneqegji, markete, llamarin punues etj), në atë hapësirë, pra a do t'ju kompensohet ajo punë atyre personave. Për fund ne dëshirojmë që objekti në fjalë të mbetet pronë e Komunës dhe të destinohet për shtëpi të pleqve pasi që është shumë e nevojshme, e jo t'i jepet ndonjë militanti t'juaj për zhvillim të ndonjë biznesi.

z. Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, fillimisht kam përgjigje parafolëses znj. Adelinë Stublla, sa i përket kompensimit të llamarin punuesve, nuk di çka u mendua me këtë por prona komunale jepet në shfrytëzim. Më parë ka qenë një rregullore dhe ata zeztar sigurisht kanë qenë para hyrjes në fuqi të ligjit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, pra kanë qenë të dhëna në shfrytëzim me afat të pacaktuar nga ana e Komunës në bazë të një rregulloreje ku me një kontratë të lidhur mes qiramarrësit dhe qiradhënësit ka qenë një nen i cili ka thënë se atëherë kur prona përkatëse i duhet qiradhënësit, kjo e fundit e shkëput kontratën, do të thotë ata perona kanë pranuar ato kushte të kontratës, kanë punuar sa kanë punuar në pronë komunale dhe tani ju janë hequr ato objekte, sigurisht është duke u bërë fjalë për objektin e pushimores. Gjithashtu sa për njoftim ne kemi vendimin e Kuvendit të Komunës që nga 10 maji 2013 sipas të cilit është paraparë që ai objekt të jepet në shfrytëzim me destinim ashtu siç ka qenë i përcaktuar, pastaj Komisioni përkatëse tri herë ka shpall njoftime publike dhe nuk kemi pasë as më të voglën ofertë për objektin në fjalë, andaj askush të mos mendoj se ai objekt po tentohet të tjetërsohet sepse nuk mundemi por i njëjti mbetet pronë komunale, mirëpo mendohet të jepet në shfrytëzim konform ligjit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, me kompensim, si dhe jepet për të mirë të dyfishtë, të krijohen të hyra për Komunën dhe të ketë zhvillim ekonomik në rajonin e Orllanit, e që mendoj se me hapjen e ndonjë biznesi në atë objekt direkt ndikon edhe në zhvillimin e bujqësisë dhe fushave tjera.

Sa i përket mos inkasimit të borxheve nga shfrytëzimi i pronave komunale, janë procedura tjera përmes procedurave përmbarimore, dhe të jeni të bindur se çdo pronë komunale që është në shfrytëzim dhe ka borxhe ndaj Komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, përmes zyrtarit për konteste juridike, janë proceduar në procedurë përmbarimore. Prona për të cilën po e përmend nga vendi një këshilltar, ka të bëjë me ish banka në qendër të qytetit të cilin e ka pas në shfrytëzim zotëri Softolli, shfrytëzim i cili me kërkesë të po atij shfrytëzuesi kontrata është ndërprerë për arsye të qirasë së lartë dhe njëkohësisht ka paguar gjithë borxhin, pra ai lokal i është kthyer Komunës dhe besoj se shumë shpejt do të mblidhet komisioni përkatës dhe për atë lokal do ta shpall njoftimin publik.

Sa i përket tjetërsimit të pronës, ishte një akuzë e rëndë që mu bë nga një parafolës dhe nëse ajo qëndron unë do të duhej të shkoja në burg sepse një gjë e tillë është vepër penale, mirëpo unë ja dokumentoj atij dhe këtu kam fletën poseduese e cila konfirmon se nuk është e vërtetë ajo që u tha, për më shumë, në vitin 2007 ju ka dhënë prona prej 16 hektar Agim Ademit, po ajo pronë pas dy viteve, me një vendim të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë ju ka marrë atij personi pasi që KEK ka bërë ankesë. Pra kadastrit është servis, është një kompetencë e deleguar, baza e

kadastrit është Agjensioni Kadastral i Kosovës - AKK, çdo të dhënë që e bëjmë ne automatik shkon në AKK ku kontrollohet edhe prej atyre, kështu që ne nuk guxojmë të bëjmë tjetërsime të pronave. Për fund, edhe njëherë e sqaroj se Agim Ademit ja kemi marrë jo 16 hektar, por 96 ari të cilat i kemi kthyer në pronë të KEK, mirëpo këshilltari nuk përmendi persona që i takojnë subjekti të tij politik siç është z.Shemsi Veseli i cili ka kërkuar 9 hektar tokë dhe Avokati i tij më ka ngritur kallzim penal ku edhe kemi shkuar në Gjykatë ngase nga viti 2010 nuk e kam bartur atë pronë edhe pse kanë qenë dy aktgjykime të plotfuqishme prej disa ish gjyqtarëve të cilët fatmirësisht Këshilli Gjyqësor i ka përjashtuar, dhe tani ajo pronë vazhdon të mbetet pronë komunale për vet faktin që Ekzekutivi ka këmbëngulur për një gjë të tillë, andaj akuza të tilla nuk është mirë të bëhen sepse me fanatizëm e kemi ruajtur pronën komunale, pra gabohet kushdo që thotë se Komuna e Podujevës ka bërë tjetërsim të pronave, dhe një gjë e tillë nuk do të ndodh asnjëherë sa nga ne.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimi u konstatua se me 17 vota për, 14 kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet propozimi i vendimit për ridestinimin e objektit "Pushimorja për fëmijët bonjak" në fshatin Orllan.

8. Themelimi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ka qenë kërkesë e Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS që në këtë mbledhje të vijë si pikë urgjente ngritja e këtij Komiteti për arsye ndarja e shtëpive të ndërtruara në Lagjen e Dëshmorëve nuk është bërë dhe ka mbetur peng si shkak i mos themelimit të këtij komiteti sepse është i vetmi mekanizëm për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimit të Komisionit për ndarjen e shtëpive në lagjen e cekur. Kjo temë është shqyrtuar në KPF dhe është rekomanduar që të përfshihet si pikë në mbledhjen e Kuvendit. Në mbledhje u rekomandua edhe struktura politike e përfshirjes, gjithashtu duhet respektuar edhe ligjin për barazinë gjinore.

z.Avni Fetahu, theksoi, në mbledhjen e KPF Drejtori i DSHMS ka pasqyruar nevojën e themelimit dhe rëndësinë e këtij Komiteti, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së për anëtarë/e propozojmë znj.Liridona Shabanin dhe Qëndrim Softollin.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi paraqitur shqetësimin se pse këto komitete nuk janë themeluar më herët, ndoshta për arsye se komitetet e përhershme kompensohen ndërsa këto jo. Është e nevojshme që edhe këto komitete t'i themelojmë dhe kurdo që kërkohet diçka prej tyre të jenë funksionale. Në përbërje të këtij Komiteti propozojmë z. Vendenis Lahun.

z.Arbër Blaku, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së si anëtar në përbërjen e këtij Komiteti propozojmë z.Bashkim Sylën.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket ankesës së z.Fitim Haziri rreth themelimit të komiteteve tjera obligative, ju njoftoj se ne kryesuesit e Kuvendeve të Komunave kemi qenë në 2-3 takime ku është diskutuar kjo çështje, është në proces të miratimit një akt nënligjor ku do të rregullojë çështjen e themelimit të të gjitha këtyre komiteteve ku parashihet që të bëhet edhe kompensimi i tyre dhe besoj se edhe komitetet aktuale që i kemi sipas atij akti do të pësojnë ndryshime për nga struktura e përfaqësimit. Pra e themelojmë këtë komitet që është shumë e nevojshme pasi që pos tjerash merret me shqyrtimin e ankesave ndaj vendimit të Komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, ndërsa komitetet tjera pasi që të miratohet akti i cili

është në proces. Kryesuesi në vazhdim ftoi zyrtarin ligjor, i cili bëri sqarimet sipas memorandumit të lidhur në mes Kryetarit të Komunës me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Rregullores komunale për caktimin e kritereve për dhënien e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

z.Vendenis Lahu, theksoi, siç shihet fjala është për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenien Sociale e jo për komisionin për shqyrtimin e ankesave, pra duhet ta kemi të qartë se fjala është për dy çështje substancialisht të ndryshme, sikurse u theksua se nominimi im në kuadër të këtij Komiteti paraqet konflikt të interesit pasi që jam edhe Komisionin për ndarjen e shtëpive, atëherë do të ishte konflikt interesi nëse unë marr pjesë në shqyrtimin e ankesave. Pra nuk është konflikt i interesit që unë të jem anëtar i këtij Komiteti, është jo logjike. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale është strukturë më e madhe se sa Komisioni për ankesa, këtë ta kemi të qartë. Konflikti i interesit është vetëm pjesëmarrja në shqyrtimin e ankesave. Konflikt interesi në Komitetin në fjalë është non sens.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mos të ngutemi sepse në çështjet juridike ka analogji, ne shume herë kemi lexuar kodin e mirësjelljes, edhe për konfliktin e interesit ku thuhet se në rast se një organ administrativ në një çështje të caktuar bie ndesh apo ka konflikt interesi ai e paralajmëron, që do të thotë se edhe Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nëse njëri prej anëtarëve të Komitetit ka konflikt të interesit për një çështje të caktuar ai e lajmëron dhe tërhiqet kështu që e merr vendimin komisioni tjetër, sikurse kemi raste të komisioneve të rekrutimit etj. Këtu na obligon ligji kur ka konflikt të interesit. Në këtë rast ky mund të tërhiqet ndërsa në Komitet mbetet. Sot e kemi në rend pune themelimin e Komitetit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ekziston konflikt i mendimeve sepse këtu po rezulton se Komiteti po themelohet pas Komisionit, dhe në këtë kontekst disa prej këshilltarëve janë përfshirë në Komision pa qenë i ngritur Komiteti, sepse po të ishte i themeluar Komiteti, anëtarin e LVV, për të cilin po debatohet se ka konflikt interesi nuk do ta caktonim në Komision sepse do të kishte konflikt interesi. Unë mendoj se për çështjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve do të detyrohemi për të ngritur një komision tjetër. Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozon z. Fatmir Rudari në përbërje të këtij Komiteti.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, është kriter që në kuadër të Komitetit në fjalë të përfillet diversiteti gjinor, ndërsa për atë që u theksua për të ngritur një komision i veçantë për shqyrtimin e ankesave të kësaj natyre, ne kemi Rregulloren përkatëse në fuqi ku këtë kompetencë ia njeh këtij Komiteti dhe përderisa kemi Rregulloren nuk mund të themelojmë komision.

z.Agim Behluli, theksoi, unë jam kryesues i Komisionit për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, prej banorëve janë parashtruar 68 kërkesa dhe është shumë normale që 48 prej tyre ndahen të pakënaqur, ndërsa prej tyre kemi vetëm një ankesë. Ne si Komision jemi mundur që të jemi sa më real dhe objektiv në përzgjedhjen e atyre që do të përfitojnë shtëpi. Kërkesa ime është që të themelohet ky komitet në mënyrë që të shqyrtojë atë ankesë dhe të hapet rruga që ne të procedojmë më tutje, sepse shtëpitë dhe infrastruktura sipas projektit janë të përfunduara. Kam edhe një kërkesë, z.Bajram Ajeti pat premtuar se do të shkojmë te Ministri i MPMS dhe të kërkojmë mbështetje për përfundimin e projektit për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, mirëpo deri më tani kjo nuk është realizuar.

z.Bajram Ajeti, theksoi, i gjithë Kuvendi duhet të ngarkohet me çështjen e respektimit të barazisë gjinore, por unë dua të theksoj se në rend pune kemi formimin e Komitetit në fjalë dhe kjo është detyra jonë, se çka shqyrton Komiteti nuk është problemi ynë sot. Administrata do t'i dërgojë ankesën këtij Komiteti dhe Komiteti do të ulet dhe paraprakisht do të reagoj ndaj z. Vendenis Lahu, me arsyetimin se ka qenë në Komisionin e shqyrtimit të kërkesave dhe se në këtë rast duhet të

përrjashtohet se është konflikt interesi. Pastaj për çështjen e barazisë gjinore kjo mbetet problem i Kryesuesit të Kuvendit. Ndoshta mbetet që në të ardhmen Rregullorja të ndryshojë sa i përket kësaj fushe.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nga propozimet e paraqitura rezulton se struktura gjinore nuk është sipas kriterëve ligjore, kështu që kjo duhet respektuar.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, ne nuk mundemi të propozojmë znj.Mrika Thaçi, për shkak se ajo nuk i përket sferës së shëndetësisë, nuk mundën individ të caktuar prej qejfit të propozojnë, kështu që ne jemi kundër, jo që është propozuar znj.Mrika por pa praninë e saj jo.

znj.Donjeta Jakupi, theksoi, meqenëse z.Vendenis Lahu është i fushës së shëndetësisë i propozuar si anëtar i këtij Komiteti, atëherë unë propozojë znj.Tringa Sfishta për anëtare pasi që është e kësaj fushe.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të konfirmohen edhe njëherë emrat e të propozuarve para se të votohet. Nga subjekti LDK znj.Liridona Shabani dhe z.Qëndrim Softolli, nga subjekti LVV z.Vendenis Lahu, nga subjekti PDK z.Fatmir Rudari, nga subjekti AAK znj.Tringa Sfishta, nga subjekti PD z.Benjamin Ejupi, nga subjekti BK z.Avni Islami. Nga propozimet rezulton se nuk është përmbushur kriteri ligjor-gjinia femërore, ne nuk mund ta miratojmë dhe procedojmë në MAPL pa përfillur këtë kriter.

z.Avni Fetahu, theksoi, në funksion të zbatimit të kriterit të barazisë gjinore dhe të zhbllokimit të procesit në këtë rast, Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozon znj.Fatlume Jaha në vend të z.Qëndrim Softolli.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozimi i Vendimi për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje:

1. znj.Liridona Shabani
2. znj.Fatlume Jaha
3. z.Vendenis Lahu
4. z.Fatmir Rudari
5. znj.Tringa Sfishta
6. z.Benjamin Ejupi,
7. z.Avni Islami.

9. Të ndryshme

z.Avni Fetahu, theksoi, në mbledhjen e KPF-së kemi propozuar që nëse edhe ju këshilltarë jeni të pajtimit që me datën 28 nëntor 2018 si Kuvend të shkojmë në Shqipëri, për të vizituar një nga komunat për shkëmbim të përvojave dhe të njëjtën kohë për të hartuar planin vjetor për vitin 2019.

z.Fitim Haziri, theksoi, meqenëse 28 nëntori është ditë me rëndësi për kombin shqiptar ne grupi i këshilltarëve të LVV jemi pro shkuarjes vetëm se kemi kërkesë që për shkak të shpenzimeve publike vizita të mos shumë e gjatë, të jetë një natë dhe një ditë, pra shpenzimet të jenë sa më minimale.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së mbështesim propozimin, është mirë që të vizitojmë një prej kuvendeve sikurse kemi pasur rastin e vizitës dhe takimin me Kuvendin e Sarandës, ku unë personalisht kam përfituar përvoja nga komunikimi me kryesuesin e

Kuvendit të Sarandës dhe Kryebashkiakes. Gjithashtu mendoj se është e nevojshme për formimin e një komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se duhet të ngritim një grup punues për organizimin e këtij udhëtimi, atëherë tre shefat e Grupeve të këshilltarëve të LDK-së, LVV-së dhe PDK-së, të marrin për obligim punët dhe parapërgatitjet rreth organizimit të vizitës në Shqipëri si dhe për hartimin e propozim planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

Konstatim:

Njëzëri mbështetet propozimi për realizimin e vizitës së këshilltarëve të Kuvendit të Komunës në Republikën e Shqipërisë, Njëkohësisht Grupi punues (Shefat e Grupeve të këshilltarëve të LDK-së, LVV-së dhe PDK,së) autorizohet zhvillimin e punëve – aktiviteteve sa i përket përgatitjeve të vizitës së cekur dhe hartimin e propozim planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:55

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/03-0087351/18
Podujevë,
02 nëntor 2018**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**